

ZYHDI MORAVA

BIBLIOTEKA


E

8JH-32

M. 96

SHTETIT

GJIROKASTËR



TREGIME

nëpër rrugë

891.983-32

11-96

ZYHDI MORAVA

5

NËPËR RRUGË...

(Tregime dhe novelë)

~~53868~~

2742

LIBRARIJA E SHTETIT
SHKURTARIT

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

BABAI

Po vinte mbrëmja. Ajri ishte i lagur dhe gjetet e zverdhura dridheshin nëpër degë nga era e lehtë e vjeshtës. Drita humbiste ngadalë e mbrëmja po zbriste e errët. Qëndroja në dritare e prisja babanë.

Ai ishte shofer. Maqinën e kishte të vjetër, por e mbante mirë. Kur babai ndalonte përpara shtëpisë, të gjithë fëmijët e rrugës hipnin mbi karroceri. Unë qëndroja mbi timon, e tundja atë sa majtas djathtas, siç bënte babai, dhe më dukej vetja më i madh se moshatarët e tjerë, që luanin mbi karroceri.

Mbrëmjeve, sapo vinte koha që babai kthehej, ndërprisja çdo lojë, shkoja në dritare e shikoja rrugën nga vinte maqina. Prisja në heshtje. E kur shquaja dritat si dy sy të kuq e të fortë, dilja me vrap nga shtëpia dhe vrapoja drejt maqinës, që afrohej. Babai e ndalonte, më merrte në krahë, më puthte e unë dihasja si një zog i gëzuar që më në fund sheh prindin tek kthehet në fole. Hyja në kabinë e, ndërsa maqina ecte, unë mbyllja sytë, tu-

litesha në qoshe dhe më dukej sikur fluturoja. Babai qeshte, më shpupuriste flokët e zez, të butë me dorën e tij të madhe e më thoshte: «Shoferi nuk duhet të jetë gjumash. Nuk bëhesh shofer duke fjetur». Por unë s'flisja. Qëndroja ashtu me sy mbyllur, ëndërroja dhe ndjeja kënaqësi.

Po ndodhte që babai kthehej edhe më shpejt e kur shkoja në shtëpi më thoshte:

— A, sonte u vonove, Ylli.

— Nesër do të dal më shpejt — i thosha unë.

Në qytetin tonë kishte edhe maqina të tjera, por unë e dalloja zhurmën e maqinës së babait që nga larg, ashtu si dallojmë, midis shumë zërash, një zë të njohur e të dashur.

Por, një mbrëmje, babai s'po dukej.

Kishte raste që vinte në mesnatë. E unë me sy të përgjumur shikoja se shpesh nuk ishte vetëm. Me babanë vinin burra të armatosur, herë një, herë dy e nganjëherë edhe tre. Nuk e di, por ata burra me pushkë më dukeshin njerëz të mirë. Mos vallë prapë babai po vonohej edhe do të vinte me ata burrat me pushkë?

Qëndroja në dritare me sytë të mbërthyer nga rruga. Padurimi sa vinte më shtoej. Nëna përgatiste darkën e herë mbas here edhe ajo pyeste:

— E, duket gjë?

— Jo, — përgjigjesha unë.

Jashtë u err fare. Nëna ndezi llambën me vajguri. Era u bë më e fortë. Unë s'luaja nga dritarja. Më dukej sikur shihja në mes të errësirës dritat e maqinës si dy diej të vegjël e doja të rendja me këmbët zbathur, por më kot.

Natë, Dëgjohej zhurma e erës që ulërinte në

strehët e shtëpisë. Nëna më tha të haja bukë. Po unë s'lëviza nga vendi. Nëna ma solli aty tasin me fasule, e, ndërsa unë përtypesha, ajo i nguli sytë e merakosur në errësirë.

«Ç'u bë ky burrë?» thoshte nëna me vete. Ajo ishte ulur pranë meje e hante ngadalë. «Kanë ardhur kohë të këqia. Ç'nuk pret njeriu nga këta qen që na kanë zaptuar vendin!»

«Jo, babait tim s'mund t'i ndodhë asgjë. Ai është i fortë, i madh» mendoja unë.

Qetësi. Dëgjohej era, që frynte jashtë, dhe zhurma e lugëve në tasin prej balte.

— Do më? — pyeti nëna kur mbarova.

— Jo — thashë unë, — lërja babait.

— Ka dhe për babanë — u përgjegj ajo e deshi të më hidhte fasule të tjera, po unë s'hëngra më.

« Pse u vonua babai? Pse nuk duken gjëkund dritat e maqinës?» pyesja veten.

Nëna lante enët e herë-herë psherëtinte me merak. Unë vështroja nëpër natë dhe mendoja. Nuk di sa ndenja ashtu: por mbaj mend se isha kapitur për gjumë e nëna më mori në krahë, më vendosi në rroba e zuri të më mbulonte.

— Erdhi babai? — e pyeta.

— Tani vjen — tha ajo dhe më rregulloi më mirë në shtresa që të mos mbërdhija natën.

Ndërsa po më tulistë gjumi, një zhurmë monotone erdhi nga jashtë, një zhurmë e ëmbël, nanuritëse. Filloi të binte shi. E mua më dukej sikur drita e llambës zbehej e zbehej, largohej dhe shndë rrohej në diçka të papërcaktuar, më bëhej sikur muret e dhomë ish in lyer me dritë hënë. Po më tulistë gjumi...

Si në ëndërr m'u duk se dëgjova zërin e babait. I hapa pakëz kapakët e rënduar: Po, po, e kisha shumë afër. Qëndronte në këmbë pranë nënës; i gjatë, me kokën gjer në tavan, me leshra të njoma nga shiu.

— Fle Ylli? — pyeti.

— Fle — u përgjegj nëna. — U mpi duke të pritur në dritare. Po ç'u bëre, pse kaq vonë?

Zërat më vinin të qartë. Babai diç fuste në një torbë. Ai erdhi pranë meje e, duke menduar se po flija, më puthi në faqe e dëgjova fjalët: «Xhan i babait!» Qepallat i ndeja plumb të rënda, po biseda, që u zhvillua, s'më la të ëndërroja.

— Ku do vesh me këtë torbë? — e pyeti nëna.
— Bjerë e fli. Ka shkuar mesnata.

— Dëgjo këtu, grua, — i tha babai. Ai iu afrua, e zuri nga supet dhe e pa në sy. Sytë e babait shkëlqenin në dritën e llambës. — Më kanë diktuar. Në qytet s'mund të rri më.

... I tultur në rroba, me sy gjysmë të mbyllur, i vështroja ata të dy. Babai me dorën e madhe përkëdheli flokët e nënës ashtu si pat përkëdhelur shpesh të mitë, pastaj e puthi dhe e shtrëngoi në gjoks.

— Po tani ç'do bësh? — dëgjova nënën.

— Do vete partizan. Prandaj e mora këtë torbë me pak gjëra për udhë.

Nëna s'foli më. Ndenjën dhe pak ashtu të përqafuar, pastaj babai u përkul mbi mua, më shkoi atë dorë të madhe mbi ballë e më puthi me ngrohtësi në sytë gjysmë të mbyllur, e unë përsëri dëgjova: «Xhan i babait!» U ngrit, më mbuloi më mi-

rë, i hodhi nënës dorën mbi sup e që të dy dolën jashtë. Ahere s'kuptoja shumë gjëra. Unë kisha dëgjuar se partizanët qenë njerëz të mirë dhe trima, pra edhe babai ishte i mirë dhe trim.

Dera u hap e nëna hyri së bashku me erën. Ajo e mbylli mirë e u shtri të flinte pranë meje. Jashtë binte shi. Nëpër shi udhëtonte babai. Humba në gjumë. Dhe në ëndërr pashë babanë me pushkë, hipur mbi kalë, të vraponte në një luadh të madh e të gjelbër plot lule të kuqe, të verdha, të kaltra. Babai kishte një yll në ballë.

LUMTËRIA

Tej në horizont dielli humbi reve që muarën ngjyrën e kuqërreme. Një grumbull vajzash lanë punën e u nisën drejt sektorit, ku kishin shtëpitë.

Frynte një fllad i lehtë. Përreth po binte mbrëmja. Matanë xhadesë, treni mbi udhën e hekurt rrëshqiste. Shoqet qenë larguar mjaft. Ajo doli nga vreshta dhe zuri të ecte brinjë një are të mbjellë me jonxhë. Toka lëshonte një erë të këndshme. Vajza mori frymë thellë, pastaj psherëtiu me kënaqësi. Kaloi një hendek dhe doli në xhade. Maqinat shkonin lart e poshtë me zhurmë. Ajo ecte e vështronte nga Tirana, ku filluan të ndizeshin dritat si xixëllonja.

Një bori, që vinte nga mbrapa, s'pushonte. Ajo bëri nga kanali, si për të hapur udhë, po boria ulërinte akoma. Mbas pak rrotat u ndalën me zhurmë pranë këmbëve të saj. Ajo ktheu kokën e vrenjtur, por u çel menjëherë, kur pa në dritaren e kabinës të zëtorit fytyrën e Yllit.

— E, a u lodhe sot? — e pyeti ajo mbas pak.

—Klasa punëtore nuk lodhet kurrë — iu për-

gjegj ai me shaka. — Ne njerëzit e grasos jemi të fortë. Eja, do të vish?

Ajo donte të hipte në rimorkio.

— Këtu, këtu, në kabinë — tha ai.

Vajza u ul pranë tij dhe zetori u nis me uturimë. Në fillim udhëtuan pa folur. Lumtëria shikonte nëpërmjet xhamit ata që ktheheshin nga puna e dëgjonte zhurmën e motorit.

— Të pëlqen zanati, Ylli? — e pyeti ajo.

Djali ndezi dritat e u përgjegj pak si me vonesë.

— Të them të drejtën, e dua aq shumë sa çuditëm kur ngryeset dita.

— Po të isha çun, edhe unë do bëhesha shofer...

Ylli ndezi edhe aritën e kabinës. Ai i ra borisë, meqë vajzat që kishin shkuar përpara t'i hapnin rrugën dhe pa fytyrën e vajzës në pasqyrën e varur në kabinë. Pastaj hoqi këmbën nga gazi e pa kthyer kokën, tha:

— Po të kesh vullnet, ti mund të bëhesh zetoriste a shofere. Fakti që je vajzë nuk duhet të t'i ndrydhë dëshirat.

— Me gjithë mend e ke?

— A ke dëshirë? — pyeti ai përsëri.

— Shumë.

— Do të të ndihmoj me gjithë qejf. Ato që di, do të t'i mësoj edhe ty.

Heshtën. Në pasqyrën e kabinës ai vështronte sytë e zez të Lumtërisë, sytë ëndërrimtarë, që shkëlqenin...

Ate mbrëmje ajo nuk shkoi drejt e në shtëpi, por u kthye te përgjegjësi i sektorit Trokiti në derë. E hapi gruaja e përgjegjësit.

— Dua të bëhem traktoriste, — i tha ajo, pasi u përshëndetën.

— Ç'të paska shkrepur kështu, moj Lumto? — tha përgjegjësi dhe qeshi. Atë ditë kishin biseduar përsëri për kursin e ri që do të hapej. Por atij as që i kishte shkuar ndër mend se kandidatja e parë do të ishte një vajzë. Përgjegjësi i sektorit gri-si një fletë e diç shënoi në të. Ai i zgjati asaj let-rën dhe i tha:

— Jepja Vangjelit, përgjegjësit të oficinës. Tani për tani do të punosh në transport që të jesh gjith-një me zetoret. Më vonë do të regjistrohesh në kurs.

Lumtëria ja rrëmbeu letrën nga dora, e falënde-roi e u largua pothuaj me vrap. Portën e shtëpisë e hapi me vrull, aq sa e ëma u tremb.

— Ç'ke kështu që hyn si e marrë? As mirë mbrëma nuk thua. — foli ajo.

Vajza e puthi të ëmën e filloi të luante me gji-thë qejf.

— A e di, nënë? Do bëhem shofere, zetoriste.

— Të lanë mendtë?

— Kjo gjë mori fund, nënë. Ja dhe letra që ma dha përgjegjësi.

— Korba unë! — tha nëna. — Po tek ne nuk ka asnjë vajzë shofere.

— Punë e madhe! — u përgjegj vajza, ndërsa zuri të shtronte tryezën. — Do të hamë darkë, nënë?

— Po ti je vajzë, moj e zezë. Kush do të të marrë ty, po të bredhësh me traktor dhe shoferë? — tha përsëri nëna në pikë të hallit.

— Unë do të marr për burrë atë që do të më dojë dhe do të më kuptojë... Një burrë fanatik nuk kam ç'e dua.

E ëma u grind një copë herë e sa s'qau:
Kur ra të flinte, Lumtërisë iu kujtua babai që
i kish vdekur para katër vjetësh. «I shkreti baba!
Sa shumë më donte! Ai ishte karrocier, ndërsa unë
do bëhem shofer!»

Atë natë bëri një gjumë plot ëndrra të bukura.

* * *

Banorët e sektorit u habitën kur panë Lumtë-
rinë të ngarkonte në zetorin e Yllit pleh me cfurk,
tulla, zhavor e plot gjëra të tjera; u habitën, ashtu
si u habit edhe Vangjeli atë ditë kur vajza i dorëzoi
letrën. Ai e kishte parë me mosbesim dhe i kishte
thënë.

— Ç't'u desh kjo punë, moj vajzë. Ishe mirë
në fushë. — Dhe i qe drejtuar Yllit që ndodhej
aty pranë.

— Merre dhe mësoja zanatin mirë. Meqë i hyri
valles, le ta shpjerë deri në fund.

Gojët e këqia u çapëlyen e derdhën vrer, por
ajo nuk u tërhoq.

— E lanë mendtë vajzën e Fahrijes? — tho-
shin disa.

— Hidhet çupa si djalë në rimorkio? — tho-
shin të tjerët.

— Pika asaj!

— Dëgjo, moj korbë, ki kujdes ti se ke tri flokë-
prera.

Lumtëria dëgjonte fjalë lart e poshtë. Asaj i
bëhej qejfi kur shoqet e përkrahnin me fjalë të
ngrohta e të zjarrta. Punonte pa pushim. Ndiqte
kursin rregullisht e mendohej të mësonte sa më

shumë prej Yllit. Lexonte deri në orët e vona të natës.

Një të diel Ylli shkoi në stërvitje ushtarake. Plehu duhej shpënë në fushë. Zetori që në tako. Dy punëtorët e shkarkimit, Lumtëria dhe Sadiku, prisnin jashtë. Vangjeli sa s'hante veten me dhëmbë. Fusha kërkonte pleh. S'kish ç'të bënte. Doli nga zyra.

— Shkoni në shtëpi — u tha ai. — Sot s'do të punoni. — e deshi të futej prapë në zyrë, Sadiku u mat të largohej, po Lumtëria pyeti:

— Pse të ikim në shtëpi?

— Si pse? Kush do ta drejtojë zetorin?

— Unë!

— Ti?! — ai e shikoi atë me habi dhe ngriti vetullat me dyshim.

«Mbase edhe e nget — mendoi me vete. — Do të më nxjerrë nga një telash i madh.

— Po ti nuk ke patentën — tha ai.

— Do të punoj këtu brenda në sektor, në arë — tha ajo me lutje. — Plehu duhet shpërndarë me doemos.

Vangjeli u kollit me zor.

— Pa të shohim, pa të shohim... — tha.

Vajza kërceu me shkathtësi në kabinë, u ul e emocionuar në sedile dhe shkeli butonin.

Në vesh i buçisnin fjalët e Yllit:

«Shkele friksionin. Fut marshin e tretë e hiqe ngadalë këmbën nga friksioni, duke i dhënë gaz gradualisht».

Zetori lëvizi qetë dhe ajo sa s'thirri nga gëzimi. Fytyra dhe sytë i shkëlqenin. Zetori ecte nëpër oborrin e oficinës dhe Vangjeli, që në fillim s'kishte

pasur besim te vajza, u lehtësua kur pa sa mirë manovronte ajo.

Lumtëria i ndërroi marshet pa u dëgjuar asnjë kërcitje ingranazhi. Në fund frenoi para këmbëve të përgjegjësit e mbasi e nxori marshin, kërceu nga kabina poshtë duke parë e gëzuar Vangjelin.

— Të lumtë! — i tha ai. — Puno me zëtorin sot, por me kujdes!

Lumtëria nuk kishte ndjerë kurrë kaq gëzim dhe kënaqësi.

Ditët shkonin njëra pas tjetrës. Erdhi dhjetori.

Atë ditë, kur dha provat, binte shi.

Ajo doli nga dhoma, ku ishte përgjegjur përpara komisionit. Ylli, që e priste jashtë nën një strehë, pa se mbante në duar diçka të kuqe. Djalo-shi me kokë të qethur i buzëqeshi dhe e futi nën çadrën e tij. U nisën drejt shtëpisë si dy shokë të mirë pranë njëri-tjetrit. Herë mbas here takoheshin me bërryle, shiheshin në sy, qeshnin dhe ecnin. Ajo shtrëngonte patentën në gjoks e ai vështronte sytë e saj të përlotur nga gëzimi. Deshi t'ja fshinte sytë me dorën e madhe e plot kallo por s'bëri gjë. Ngriti jakën e palltos dhe vazhduan të ecnin nëpër shi.

* * *

Franvera e gjeti Yllin ushtar dhe Lumtërinë në timon. Në një ditë marsi, kur era shtynte retë e përhime në qiell, ajo vështronte nëpërmjet xhamit pranverën, që shtrinte gjymtyrët ngado. Gruri gjelbëronte nëpër ara. Toka lëshonte avull dhe petalet e kumbullave zbardhnin si qeshjet gazmore të fëmijëve.

Ajo ndaloi te peshorja anës së rrugës që të peshonte ngarkesën. Ashtu, e veshur me pantallona dhe xhakavento, dukej si një djalë çapkën.

Xha Avduli, ai plaku i thinjur që peshonte, i dha një letër. Ajo e mori me padurim, e hapi dhe e lexoi:

«Letrën tënde e mora dhe u gëzova shumë. Ti je një vajzë e mirë ashtu siç je edhe një punëtore e mirë. Zetorin tim ta kam besuar ty si gjënë më të shtrenjtë. Sillu me të si me një shok të dashur. Ti duhet ta mbash me kujdes. Mua më kanë nxjerrë në gazetën «Luftëtari» si ushtar të dalluar. Dua të dëgjoj gjithnjë mirë për ty. Uroj të jesh e palodhur! Shoku yt, Ylli!»

— E, ç'thotë? — e pyeti xha Avduli. — Djalë i hedhur ai!

Lumtëria që ndjeu në tonin e zërit të tij një një notë djallëzie, iu përgjegj:

— Më thotë që xha Avduli ka llafe shumë...

— Ah, shejtankë!

Ajo u hodh në kabinë. Çdo gjë që prekte i kujtonte Yllin. Zetori uturoi, u shkund, u lëshua nëpër rrugë. Lumtëria nisi të këndonte. Ajo çau përpara e vetëdijshme dhe e sigurt.

NË KATIN E PESTË

Ahere ishte vjeshtë. Punonim në katin e pestë e muret sa po kishin zënë të hidhnin shtat. Më ishte bërë zakon që, mëngjeseve, të shkoja shpejt në punë, të ngjitesha lart dhe të vështroja poshtë në rrugë, ku nxitonin kalimtarë të ndryshëm. Djemtë e rinj që shkonin uzinave, ngrinin sytë nga unë si të donin të thoshnin «sa e mirë dukesh atje, me ata flokë që t'i rrëmben era.» Shihja fletët e zverdhura si këputeshin nga degët, luhateshin e binin diku në rrugë. Maqinat kalonin varg njëra pas tjetrës. Pastaj vinin punëtorët e brigadës sonë. Unë qëlloja me gurë të vegjël, ata ngrinin kokët, më përshëndesnin e shkonin të vishnin rrobat e punës.

Një mëngjez, kur do të fillonte puna, në njërën nga dhomat e katit të parë që e përdornim si mence, erdhi një djalë i ri. Ai na përshëndeti dhe na dha dorën si të njiheshim prej kohësh. Me Agimin u përqaftua. Siç mësova më vonë, ata ishin shokë fëmnie. Në të parë dukej njeri i mirë. Ishte i gjatë, me flokë të verdhë të ndarë me vijë e kishte sy të

kaltër, të guximshëm, që qeeshnin gjithmonë. Që ditën e parë ai m'i nguli sytë e, të them të drejtën, kjo gjë më pëlqente. Brigadieri e caktoi të punonte në kanalet e anës së ndërtesës. Nga lart e shihja si e ngrinte kazmën dhe e ngulte me forcë në tokë. Shkëpuste një copë të madhe dheu dhe e ngrinte përsëri. Shpesh rregullonte flokët me duar, fshinte me mëngë ballin e djersirë, kthehej nga unë e më vështronte. Dielli i binte në sytë e qeshur e ata pircëroheshin nën reflekset e dritës. I përgjigjesha buzagaz e ai vazhdonte punën. Çdo ditë më dukej më i çiltër e më gazmor. Mua më pëlqente mënyra e thjeshtë si u afrohej njerëzve.

— Dukesh shumë e bukur atje, në katën e pestë — më tha një herë duke më parë në sy.

— E bukur dukem — i thashë, — prandaj rri.

— Po mua pse s'më godet me gurë të vegjël? Më mbron?

— Jo, ty do të godas me gurë të mëdhenj. — E u largova.

Kaluan disa ditë. Muret e katit të pestë po merrnin fund. Atë të shtunë, pasi mbaruam punën, punëtorët morën veglat dhe zbritën po ashtu. Kur vura tullën e fundit, vura re se kisha mbetur vetëm. Ngrita kokën lart dhe m'u duk sikur po ngjitesha drejt qiellit të kaltër, ku një re e bardhë notonte drejt lindjes. Dëgjova hapa. Kheva kokën dhe e pashë atë tek vinte drejt meje. Ai më kapi nga krahët e, pa kuptuar se ç'ndodhte, më puthi. Mistria më shpëtoi nga duart e ra pranë këmbëve. Mbeta e hutuar. U tremba kur dëgjova një zë nga dritarja e dhomës tjetër.

— Ç'të bëri ashtu, moj korbë?

Unë mora mistrinë e zbrita pa folur.

Kur u lava e u ndërrova, vura re se më shihnin sikur të më kishte mbetur ndonjë copë llaçi në flokë. Sikur më digjnin ato shikime. E kuptova menjëherë se Fatimja kishte folur e fjala kishte shkuar gojë më gojë. Kjo gjë s'më pëlqeu, u skuqa e sa s'qava. Petriti ishte larguar.

Në mbrëmje, kur rashë të flija, mendova shumë për atë që ndodhi atje, në katin e pestë. Dhe më dukej sikur bashkë me erën e vjeshtës, që vërshëllente pranë dritares, dëgjoja edhe zënë e tij. Disa herë u ngrita e shkova te dritarja. Nëpërmjet xhamit të ftohtë, shihja natën e errët, neonet e rrugës që ndriçonin deri larg. Dëgjoja vërshëllimën e erës. E diela m'u duk e mërzitshme. Të hënën shkova në punë më shpejt se zakonisht. U ula majë murit e pashë poshtë njerëz që nxitonin, djem të rinj që shkonin në uzina. Ata më vështronin sikur donin të më thoshin: « Sa e mirë dukesh atje, me ata flokë që t'i rrëmben era ». Fletët e pemëve ndiqnin maqinat si turmë e verdhë harabelash. Erdhën të gjithë punëtorët e brigadës, por ai s'po dukej.

«Pse s'erdhi?» pyeta veten.

— Pse s'erdhi sot Petriti? — pyeti brigadieri Agimin.

Të gjithë vunë buzën në gaz. Dikush qeshi. Unë ndjeva diçka që më digjte në gjoks dhe u skuqa.

Atij i kishin thënë një ditë më parë se na kishin parë e që të gjithë e dinin.

Majat e veshëve më digjnin nga të nxehtit, po kokën s'e ula. Vështroja Fatimen me inat.

Ç'i duhej asaj të fliste lart e poshtë? Fundi mua më pëlqente ai djalë. Unë e desha atë...

— Na u duk djalë i mirë — tha Aliu. — Si e bëri këtë?

— Pse, e vërtetë është? — pyeti brigadieri.
Tunda kokën për të thënë se ishte e vërtetë.
Brigadieri u mendua pak.

— Si thoni? — pyeti.

— Ta thërrasim këtu e t'i themi të bëjë auto-kritikë — tha xha Lazja.

Të gjithë qeshën. Unë isha bërë prush.

— Pse qeshni? — u nxeh xha Lazja. — Ai qen bir qeni do rrahur.

Unë s'flisja. Shokët qeshën përsëri.

— Si thoni? — pyeti prapë brigadieri.

— Unë mendoj — tha Lulja — që Agimi ta gjejë e t'i thotë të vijë përsëri në punë. Ne do të bëjmë sikur s'dimë gjë. Kjo nuk do të ndodhte sikur Fatimja ta mbyllte gojën. Ata janë të rinj, i zgjidhin vetë punët e tyre.

— Lulja ka të drejtë — u dëgjua një zë.

— Po, ka të drejtë.

— Fatimja s'duhet të merret me fjalë.

— Të heqë dorë nga ky zakon i keq...

Shihja Fatimen. Ajo qëndronte kokulur. Pastaj ndjeva vështrimet e shokëve që binin mbi mua. Edhe unë ula kokën. Së fundi thashë:

— S'besoj që mos vijë në punë nga ky shkak... Ai s'është i tillë... — Por asnjë s'u përgjegj.

Kaloi një ditë. Ai s'erdhi. Të dytën përsëri s'u duk. As të tretën e as të katërtën.

Na u shfaq një mëngjez kur s'e prisnim. Na përshëndeti me zërin e tij gazmor e të fuqishëm. Të gjithë ja kthyem përshëndetjen. Vetëm unë s'foli. Sytë e kaltër ranë mbi mua si të pyesnin:

«Më mban mëri?» Vështrimin e kalova diku tjetër.
Dëgjova që i tha brigadierit:

— Kam qenë sëmurë. Kam sjellë edhe raportin...

Mbas pak filluam punën e unë e shihja nga lart si i lëvrinin nën këmishën e bardhë muskujt e shpatullave. Fshinte me mëngë djersët e rregullonte flokët, por kokën nuk e ngrinte. Mora enën e ujit e zbrita poshtë. E mbusha e, në të kthyer, i shkova pranë. Në ballin e tij ndritnin bulat e djersës.

— U lodhe?

Petriti ngriti kokën e dielli i ra mbi sytë e ndritur.

— Pak — u përgjegj e fshiu ballin me mëngën e këmishës.

— Do ujë? — thashë dhe i mbusha gotën.

Ai ma mori nga duart e, ndërsa pinte, s'mi ndante sytë si të më thosh: «Pse u bë kështu? Ne kuptohemi, po, po, kuptohemi».

Kur ma ktheu gotën, pashë t'i hapeshin buzët të më thoshte diçka, por atë çast dikush më thirri nga lart:

— Irenë!... — dhe ika.

Në pushim e dëgjova që u thoshte shokëve:

— Ne të dy e duam njëri-tjetrin, do të fejohemi...

Dhe më regëtiu zemra nga gëzimi...

FILLI U LIDH PËRSËRI

Ata ecnin në heshtje. Dëbora shtrihej sa të hante syri dhe të merrte vështrimin me bardhësinë e saj, Qielli ishte i përhimtë, i zyrtë e i fjetur. Edhe pylli dremiste nën peshën e dëborës.

Ai që shkonte përpara kishte trup të lidhur e të fortë. Në kokë mbante një kasketë të ulur mbi sy. Ishte rreth të tridhjetave. E quanin Rakip.

Tjetri, Pirua, dukej më i ri. S'tregonte më shumë se 24 vjeç. Ishte i gjatë e i hollë e kishte sy shumë tërheqës. Flokët gështenjë, të butë e të njomur nga dëbora, i binin mbi ballin e gjerë. Vetullat e mëdha dhe të zeza i lëviznin herë pas here me shqetësim.

«Do t'ja gjej rastin e pastaj do t'ja tregoj qej-fin»— mendonte ai që ecte përpara.

Dëbora shtrihej e bardhë, e qetë, përpara tyre. Ai që shkonte mbrapa hukaste duart.

— Mos ke gjë shkrepse? — pyeti Pirua.

Tjetri s'foli.

— Imja qenka njomur.

Përsëri heshtje.

— A ke shkrepse? Ty, Rakip të them!

— Jo! — hunguroi ai që shkonte përpara.

Ecnin. Ishin dy fillrojtës. Diku ishte këputur linja. Kur përgjegjësi caktoi Rakipin për të ndrequr difektin dhe e pyeti se cilin do të merrte me vete, ky iu përgjegj:

— Atë të riun — dhe e tregoi me gisht.

«Do të rregullojmë më parë linjën e pastaj...»

— mendonte Rakipi.

Vazhdonin të ecnin pa folur.

Pirrua kishte ardhur para dy javëve në atë kolektiv. Ai do të kryente atë stazhin e kandidatit të partisë. Ishte njohur shpejt me shokët. Dhe një herë ndërmjet tij dhe Rakipit qe bërë kjo bisedë:

— Je i martuar? — e kishte pyetur Pirrua.

— Jo.

— As i fejuar?

— As i fejuar. Po ti?

— Unë po.

— I fejuar?

— Jo, i martuar.

Rakipi e kishte parë në sy me habi.

— Kaq i ri?

— Dashuria s'pyet për moshë, vëlla.

— Ta merr mendja...

— E ke provuar?

— Si të të them... — Dhe kish mbledhur supet.

— Vajza që desha unë, ishte e fejuar — vazhdoi Pirrua. — E kishin fejuar në moshë të njomë. Ishte tej nga qyteti juaj. Ajo nuk e donte. U njoh me mua, u pëlqyem dhe u martuam... Kjo ndodhi para një viti e ca. Tani pres fëmijën e parë.

Rakipi e kishte dëgjuar pa ja ndarë sytë. Kur mbaroi e pyeti:

— Si e quajné?

— Dallëndyshe.

— Hëëm — Ai kishte shtrënguar dhëmbët.

— S'të pëlqen emri?

— Jo, jo, i mirë është...

«Sot do t'ja tregoj qejfin» mendoi me vete Rakipi.

«Po ç'faj ka ai? Edhe ajo as që më njeh. Eh, ta marrë djalli.»

Era filloi të ngrihej e fortë dhe e ftohtë.

«Këtë pranverë bëhem me fëmijë — mendonte Pirrua. — Si do t'ja vë emrin?»

— Ej, Rakip!

— Hë.

— Më gjej një emër vajze!

— Ç'e do?

— T'ja ngjis vajzës sime kur të lindë këtë pranverë...

Era i mori ato fjalë dhe i thërmoi mbas shkëmbinjve.

— Më gjej një emër të bukur.

«Ta tregoj atje lart emrin ty, po prit, prit» mendonte Rakipi.

Degët e pemëve nën forcën e erës filluan të shkundnin dëborën. Ata ecnin, secili me mendimet e veta dhe era, si për inat, sa vinte shtojte. Mbërritën. Ndaluan dhe filluan nga puna. Era ulërinte dhe vërshëllente nëpër tela. Rakipi filloi t'i ngjitej shtyllës.

— Vëri këmbalecat! — i thirri Pirrua.

— Duhet të mësohesh, picrrak. Edhe kështu

duhet të mësohesh. Ja, shiko — u mat t'i ngjitej shtyllës.

— Është lagështirë — vazhdoi Pirrua megjithëqë i dogji fjala picrrak. Por Rakipi u ngjit dhe filloi nga puna. Era s'pushonte së ulërituri, dhe teksa pritej nëpër tela, vërshëllente si qindra gjarpërinj së bashku.

Pirrua deshi të pinte duhan. Filloi të mundohej edhe një herë me shkrepjen e njomur. Atë çast ngriti sytë dhe pa Rakipin të rrëzohej në dëborë. Vrapoi t'i thoshte: «E, të thashë?». Po kur e pa ashtu, i erdhi keq.

— U vrave?

Tjetri s'foli.

— U vrave, more?!

— Jo...

Dukej qartë se ai kishte thyer këmbën. S'ngrihej dot. Pirrua e hoqi andej, i hodhi peliçen e tij sipër dhe mbathi me të shpjetë këmbalecat. Kur mbaroi punë, zbriti poshtë dhe pa se peliçja ishte hedhur si lëkurë e harruar mbi dëborë.

— Pse e ke flakur? — pyeti.

Rakipi nuk ju përgjigj.

— Pse, pra?

— Nuk e dua.

Pirrua, i çuditur, e veshi dhe u mat ta kapte shokun nga krahu.

— Mos më prek, — thirri Rakipi. — S'kam mbetur në dorën tënde. Zvërrë do të hiqem dhe... Kisha qejf të të rrihja, por pate fat...

— Pse?!

Rakipi e pa në sy me inat.

— Ti më ke marrë të fejuarën... Ah, pate fat.

Po mirë më gjeti. Ç'më duhej të ngjitesha pa këmbaleca?

Pirrua mbeti në këmbë i ngrirë e i hutuar. S'e priste kurrë këtë gjë.

Era frynte dhe përplaste dëborën mbi ta.

Rakipi u ngrit si të donte të ecte, por, pa bërë as dy hapa, u përplas mbi dëborë. Pirrua e rrëmbeu nga mezi.

— Lëshomë!

Pirrua e hodhi mbi kurriz.

— Lëmoshë të them!

Tjetri u nis. Mezi ecte nëpër dëborë. Djersa i rridhte anës së buzëve. Bënë shumë udhë ashtu pa folur.

Pastaj diku ndaluan. Pirrua e uli shokun mbi një shkëmb dhe fshiu djersët me mëngë. Heshtën. Mendonin. Era sikur u platit. Pirrua u çlodh mirë.

Tjetri mendonte. Ç'mendonte!?

«Ç'faj kanë ata?» — thoshte padashur me vete. Ecën dhe për shumë kohë me mundim të madh. Pirrua herë-herë gulçonte. Një herë u rrëzua. Prapë u ngrit, po shoku nuk e la. Tjetri mendonte e mendonte.

Së fundi arritën.

Dhe ai, për të parën herë që nga çasti i nisjes, i foli me dashamirësi. Nuk mund të rrinte pa i folur.

— Në të lindtë vajzë...

Pirrua e pa në sy.

— ... quaje Dashuri!..

DALLËNDYSHET E PABA

Ferma u zgjua.

U zgjua edhe Sadriti. Doli nga dera, ngriti jakën e palltos dhe u nis për në punë. Me të arritur te vendi, u ul në një nga stolat përpara mensës dhe priti brigadierin. Punëtorët vinin grupe-grupe, përshëndesnin dhe hynin në mensë. Një tufë rosa të egra zhurmuan përmbi kodër.

— Sjellin dimër — tha njëri aty pranë.

Sadriti i rdoqi me sy gjer larg. Rosat u larguan, humbën në horizont. Një mjegull e lehtë lundronte andej nga vreshtat e tretej në hapësirë. Sadriti ktheu sytë nga ai që kish thënë se rosat sjellin dimër. Ishte një burrë jo shumë i gjatë, i hollë, me flokë të rënë. Gishtat i kishte të mëdhenj e të trashur nga puna. Burri po dridhte një cigare. Sadriti futi dorën në xhep e nxori paketën «Partizani».

— Merr një gati — i tha.

Tjetri e shikoi në sy, u afrua, mori cigaren dhe

falënderoi. Nxori shkrepse, ndezi cigaren e Sadritit, pastaj edhe të vetën. E thithi fort dhe nxori tymin nga hundët.

— Përse ke ardhur? — e pyeti Sadritin.

— Dua të punoj këtu — u përgjegj djaloshi dhe u largua pak si për t'i bërë vend që të ulej. Burri me flokë të rënë u ul e vazhdoi ta pyeste:

— Nga vjen?

— Kam qenë ushtar.

— Dhe do të punosh këtu në fushë, në bujqësi? Po këtu të del shpirti, mor djalë. Unë jam karrocier — vazhdoi ai, — nuk lodhem dhe aq shumë, por përsëri mërzitem. Le pastaj po të jesh në fushë, në baltë e në të ftohtë! Të dhëmbin duart e nuk ke fuqi as të ngresh kazmën e as të ngulësh belin. Shko më mirë në ndonjë vend tjetër. Ç'të duhet bujqësia ty? Do marrësh veten më qafë!

Sadriti nuk iu përgjegj. Ai vështronte një grup grash e vajzash që po afroheshin. Hodhi cigaren përtokë, e shkeli me këmbë dhe pyeti njeriun pa flokë që vazhdonte të fliste:

— Cila është brigadierja?

— Cila brigadiere?

— Luljeta.

— Ajo e mesit — tha burri.

Ai u ngrit e, kur ato u afruan, i doli përpara brigadieses.

— Ju jeni Luljeta?

— Po — tha ajo. — Dëshët gjë? — dhe pushoi së qeshuri.

Të tjerat u larguan për në mensë.

— Po! — i tha ai asaj, duke i zgjatur një letër, — më kanë dërguar të punoj tek ju.

— Shumë mirë — tha vajza, pasi e lexoi. —
Doni të filloni që sot?

— Si të doni...

— Prisni pak sa të ha mëngjezin dhe pastaj
ju tregoj punën — tha ajo dhe u largua.

Burri pa flokë iu afrua.

— Besoj se do të të pëlqejë — tha ai me ironi.

Atë çast doli Luljeta.

— Shkojmë — i tha Sadritit.

Ai e ndoqi nga pas. Ecnin të dy në heshtje.

Kur dolën nga magazina, Luljeta kishte një bel e
një lopatë në duar.

— Po vegla për mua?

— Ja ku i kam.

Ai qeshi lehtë dhe ja mori veglat.

— A nuk është turp për mua që veglat të m'i
mbani ju?

Filluan të ngjiteshin në kodrën me hardhi. Shiu
që kish rënë një natë më parë e kishte zbutur tokën.
Këpucët e Sadritit herë pas here ngelnin në baltë.
Në një farë vendi, duke e tërhequr këpucën me
forcë, atij iu këput lidhësja. Vajza, që ishte me
çizme, ecte lirisht. Kur pa ç'i ndodhi shokut, ndaloi.

— Mos u mërzit,— i tha ajo.— Nesër do t'i
them magazinierit të të japë çizme edhe ty.

Sadriti nxori këpucën nga balta dhe të dy
vazhduan t'i ngjiteshin kodrës. Kur arritën në majë,
u ndalën një çast te tenda. Kodrat e vogla, të mbje-
lla me hardhi, dukeshin si një amfiteatër gjigand.

Dielli doli mbi majën e Dajtit. Era përkëdhelte
flokët e dy të rinjve. Retë dhe mjegulla po hum-
bisnin tutje. Qielli po pastrohej ngadalë. Lart, në
kodrat e Kasharit, dukeshin fëmijë që shkonin në

shkollë. Treni kaloi atje poshtë dhe lëshoi një fishkëllimë të fortë.

— Sot do të punojmë në parcelat eksperimentale — tha brigadierja.

Kur arritën në vendin e punës, ai hoqi xhaketën dhe e vuri në degën e një peme. Luljeta nxori nga toka një bel dhe një lopatë.

— Ç'do të bëjmë? — pyeti Sadriti.

— Do të hapim gropa — u përgjegj ajo. — Pranë çdo hardhie, do të hapim nga një gropë 40 me 40. Largësia nga rrënja duhet të jetë 20 cm.

Sadriti pohoi me kokë. Ajo vazhdoi:

— Në çdo gropë do hidhet nga 20 kg. pleh organik i përzier me treqind gram superfosfat. Fillojmë?

— Fillojmë — tha ai.

— Unë po marr këtë rresht ju merrni tjetrin. Ajo e nguli belin thellë në tokë me tërë forcën. Edhe ai filloi nga puna. Punëtorët e tjerë po kra-sitnin pak më poshtë në këmbët e amfiteatrit. Herë mbas here era sillte tek ata fjalë të shkëputura. Të dy punonin me vrull.

— Sa gropa bëre? — e pyeti ajo duke ngritur me kurrizin e dorës së djathtë flokët e zez të rënë mbi ballë.

— Katër, po ti?

— Gjashtë.

Ai e shikoi me vërejtje.

— Vërtetë?

Vajza qeshi ëmbël, ashtu siç qeshte shpesh me njerëzit e afërt.

— Do të të arrij — tha ai dhe filloi të punonte më shpejt.

Ecnin pothuaj paralel. Pika djerse binin në tokën që avullonte.

Të dy punonin shpejt e me kujdes.

— A e vazhdon shkollën? — pyeti Sadriti duke drejtuar trupin. Vajza ishte përkulur e po që ronte dheun nga gropa.

— Po— tha ajo.— Vazhdoj vitin e parë të teknikumit katërvjeçar, këtu në fermë. Të gjithë ata që nuk e kanë mbaruar klasën e tetë vazhdojnë mësimet tri herë në javë.

— Domethënë ti do të bëhesh agronome e mesme — tha djali. — S'është cudi që më vonë të vesh edhe në shkollën e lartë.

— E pse jo? — tha vajza. — Ç'më mungon? Po ti?

— Vazhdoj vitin e dytë të gjimnazit.

— Shumë mirë.

Djaloshit i pëlqeu çiltërsia dhe besimi i kësaj vajze.

— A shkojnë të gjithë rregullisht në shkollë? — pyeti ai përsëri.

— Jo të gjithë. Ka nga ata që nuk i japin rëndësi çështjes së shkollës dhe nuk vijnë rregullisht në mësimet. Më e keqja është se disa prej tyre janë të rinj.

Sadriti ngriti sytë dhe e shikoi. Vështrimet e tyre u kryqëzuan. Ajo qeshi ëmbël. Edhe ai qeshi. Pastaj të dy ulën kokën e vazhduan punën. Avulli ngrihej zvarrë nëpër tokë. Dheu lëshonte një aromë dehëse, e cila i pëlqente shumë Sadritit. Ai u mbush me frymë dhe psherëtiu plot kënaqësi. Brigadierja e pyeti:

— E, u lodhe?

— Jo, kjo era e tokës sikur ma mbush kraharorin me diçka të lehtë, të këndshme — u përgjegjë ai pa ndërprerë punën.

Si kaluan disa minuta në heshtje, ajo pyeti përsëri:

— Ç'njerëz ke?

— Babanë, një motër e një vëlla më të vogël.

— Ku të punon motra?

— Është e martuar.

— Tre burra në shtëpi dhe asnjë femër që të lajë, të rregullojë e të pastrojë. Ti duhet të martohesh, Sadrit.

Djaloshi ngriti kokën dhe pa se mos ajo ja kishte hedhur me qëllim ato fjalë. Por e fshiu mendimin e keq menjëherë se vajza punonte me vrull. Fytyra e saj qe e qetë dhe e padjallëzuar.

— Nuk e kemi dhe aq të vështirë — tha ai.

— I kemi ndarë detyrat.

— Sidoqoftë femra duhet në shtëpi. Babai do të kënaqet dhe ti do të jesh më i qetë e më i gëzuar.

— Ti flet sikur të kesh jetuar në shtëpinë tonë — ja ktheu ai, — por unë nuk kam përse të nxitohem. Duhet të gjej në jetë një shoqe që të më përshtatet; të më kuptojë dhe ta kuptoj.

— E pse, nuk paska vajza të tilla?

— Sigurisht që ka, por duhet t'i njohësh, në punë, në shkollë. Mua më duket budallallëk t'i dalësh një vajze në rrugë e t'i propozosh për martesë pa ditur cila është, si e quajnë dhe me se merret... Bukuria nuk ka asnjë vlerë po qe se vajza është llafazane dhe egoiste.

Lulieta mbaroi grupën e filloi një tjetër.

Dielli ishte ngritur lart. Rreshtat e hardhive

dukeshin si shkallë. Balta ngjitej pas veglave.

— Nuk më fole për nënën — tha ajo pas pak.

— Për nënën? — Ai ngriti sytë. Ajo e vështronte disi si e penduar që kish bërë një pyetje, e cila mund ta lëndonte.

— Nënën mezi e sjell ndër mend — tha ai. — Fytyra e saj më është e turbullt. Por unë e di, e ndjej që ajo ka qenë shumë e bukur dhe shumë e mirë. Vdiq kur po lindte tim vëlla, Agimin. Atëhere unë isha dy vjeç.

— Po babai nuk u martua? — pyeti vajza me keqardhje.

— Jo. Ai e donte jashtëzakonisht nënën. Akoma dhe sot flet me respekt të madh për të.

— Më vjen keq — psherëtiu vajza.

Heshtje.

— Sa gropa bëre? — e pyeti ai mbas pak.

— Njëzet e shtatë — u përgjegj ajo pa ngritur kokën.

— Sa është norma?

— Dyzet.

— Paske bërë tri gropa më shumë.

— Edhe ti punoke, të lumtë. Nesër do të ma kalosh, me siguri.

Të dy lanë belat, ngritën kokët dhe u shikuan në sy.

Ajo kruajti belin me lopatë.

Ndërkohë punëtorët, që krasitnin poshtë, lanë punën dhe filluan të ngjiteshin lart.

— Ku shkojnë ata? — pyeti Sadriti.

Luljeta hodhi sytë në drejtim të punëtorëve.

— Me sa duket, erdhi koha për të ngrënë drekën.

Edhe ata u nisën.

Duke parë erën që luante me kaçurrelat e vajzës, atij iu kujtua biseda me atë burrin pa flokë dhe e pyeti Lulietën se cili ishte ai.

— Rrema? — pyeti vajza.

— Nuk ja di emrin — tha ai — Është ai karrocieri pa flokë.

— Ah, Ai është dembel i madh, për më tepër të gjithë e njohim si llafazan. Po përse pyet për të?

— Ashtu kot.

Ata u bashkuan me punëtorët e tjerë.

— Si kaluat? — pyeti Luljeta.

— Shumë mirë, po ju?

— Edhe ne mirë — u përgjegj brigadierja.

Sadriti s'fliste. Ecte ngadalë dhe herë pas here vështronte ata që tani e tutje do të ishin shokët e tij të punës.

— Si të quajnë? — e pyeti një burrë i moshuar

— Sadrit — u përgjegj ai dhe e shikoi në sy, atë që e pyeti. — Po ty?

— Dullë Qylafi.

— Është vëllai i karrocierit — i tha Luljeta me zë të ulët. — Ky nuk është llafazan, por fanatik i madh.

Ecnin, flisnin e bënin shaka.

Sadriti ndjeu se dy sy të kaltër e vështronin me vëmendje. Ktheu kokën andej dhe buzëqeshi lehtë. Sytë u turpëruan dhe u ulën poshtë.

«Cila është kjo», mendoi. «Përse hesht ndërsa gjithë flasin e bëjnë shaka? Sa e bukur qenka!»

Të gjithë hynë në mensën e thjeshtë por të pastërt. Punëtorët u ulën në tryeza të mbuluara me mushama, ku avullonin pjatat me gjellën e

ngrohtë. Lulieta dhe Sadriti hanin të qetë, si dy shokë të njohur prej kohësh.

Një djalosh me flokë kaçurrelë u afrua, u ul pranë Sadritit dhe e pyeti:

— Sot fillove?

— Po.

— Më quajnë Ismail Seferi.

— Sadrit Shpata.

Ata i shtrënguan duart njëri-tjetrit.

Luljeta u skuq pakëz. Ngriti sytë nga pjata dhe e vështoi Ismailin. Duket se sjellja e tij i pëlqeu.

— Po ti, Luljeta, ç'bëre? Bashkë punuat sot?

— Po, bashkë — u përgjegj ajo.

— Shumë mirë — tha ai.

— Po ti ku punove? — pyeti Sadriti.

— Hapa gropa për qershitë.

— Sa gropa bëre?

— Katër.

— Sa e keni normën?

— Gjashtë — u hodh Luljeta.

— E sheh — e ngau Ismaili, — si brigadiere që është i di të gjitha.

Qeshën të tre.

Sadriti hante dhe e ndjente forcën e atyre syve të kaltër, që vazhdonin ta shikonin me vëmendje. Edhe të tjerët e vështronin, por në ata dy sy kishte diçka të veçantë. Ai e shikoi, i buzëqeshi përsëri, ndërsa ajo uli kokën.

Ata të tre dolën dhe u ulën në një lëndinë aty përpara. Luljeta, e veshur me pantallona, rrinte lirisht si djemtë. Sadriti i dha një cigare Ismailit. Ky e ndezi dhe e thithi fort. Ai nxori nga goja tymin dhe buzëqeshi i menduar. Ismaili e pyeti:

— Ku ke qenë ushtar?
— Reparti ndodhej në Elbasan, por kishim edhe një pikëhapje në malet e Skraparit.

Vajza me sytë e kaltërt, të mbuluar me qerpi-kë të gjatë dhe të zez, u afrua. Luljeta e pa dhe i foli:

— Zelig, eja rri me ne.

Sadriti ktheu kokën dhe e shikoi përsëri me vëmendje.

Zelia erdhi dhe u ul pranë tyre. Flisnin për punën, për rendimentet që do të merrnin. Pastaj folën edhe për librat. Zelia e vështronte Sadritin. Ajo e dëgjonte tek fliste. Aty pranë ishte edhe i ati.

— Erdhi ora e punës — tha një nuse e re që sapo doli nga mensa.

— Ngrihemi — tha Ismaili, duke parë orën. Të gjithë u ngritën. Ismaili u nis nga qershitë.

— Cila është ajo që na tha të ngrihemi? — e pyeti Sadriti Luljetën kur arritën në vend dhe filluan përsëri punën.

— Është nusja e Zenel Qylafit. Ajo ka qenë një nga aktivistet e organizatës së rinisë, por që kur është martuar ka rënë në plogështi dhe duket si e drojtur. E quajnë Nurie. Zelia, vajza që thirra unë, e ka kunatë.

— Zelia qenka vajza e Dullës? — tha Sadriti.

— Mos u çudit. Ajo i ka ngjarë së ëmës. Është shumë e mirë dhe kërkon të jetë gjithnjë në ballë për të marrë pjesë kudo. Por i ati i ngrihet si barrikadë dhe e frenon.

Sadritit filluan t'i ngatërroheshin mendimet dhe t'i bëheshin lëmsh. Ai pyeti:

— Po Ismaili si është?

Ajo u skuq pakëz, hodhi lopatën me dhe e u përgjegj:

— Nuk është i keq.

— Aha e kuptova — tha ai.

Luljeta ngriti kokën dhe ata u panë në sy. Qeshën.

— Jeni fejuar?

— Akoma jo. Mendojmë të fejojemi së shpejti. Kur lanë punën, dielli qe anuar nga perëndimi dhe retë kishin filluar të skuqeshin. Një harabel fluturoi me cicërimë.

— Sa gropa bëre? — pyeti ai, si fshehu veglat.

— Dyzet e nëntë.

— Prapë ma paske kaluar.

— Pse, sa bëre ti?

— Dyzet e tre.

— S'ka gjë, do të më arrish nesër.

— Po, po, — tha ai.

— Po shkoj të kontrolloj punën e punëtorëve — tha vajza. — Natën e mirë, Sadrit.

— Natën e mirë, Luljeta, mirupafshim nesër.

Vajza u nis tatëpjetë vreshtit e humbi midis rreshtave të hardhive. Ai mori xhakatën, e veshi dhe doli në xhade. Shtëpinë e kishte larg. Filloi të këndonte një këngë popullore nga ato të Isuf Myzyrit. Plepat bri rrugës ishin zhveshur. Kamionat kalonin radhaz. Autobusi i punëtorëve erdhi, por Sadriti vijoi rrugën më këmbë. Sytë ngjyrë gështenjë i ndritnin.

II

Kishin kaluar ditë e javë. Një natë, megjithëse kishte rënë më shpejt se herët e tjera, Zelinë nuk po e merrte gjumi. Rrotullohej sa në një krah në tjetrin, por më kot. Qindra mendime i vërtiteshin nëpër kokë, mendime të ndryshme, të pastra e të turbullta. Një rreze hëne futej përmes dritares në dhomë e binte mbi shtratin e vajzës. Ajo e vështroi atë rreze drite, pastaj puliti sytë, psherëtiu. Futi duart nën jorgan, të cilin e ngriti gjer te mjekra e ra përsëri në mendime. I ati, Dulla, e kishte fejuar që në fëmëni me një djalë që s'qe i keq në pamje. Por Zelia e ndjente se nuk mund ta dashuronte. Për këtë mendohej. Sa mirë i thoshte Luljeta «lëre». Po tata? Po xhaja? Dulla e kish kërcënuar «Po dëgjova kaq — dhe kish vënë gishtin e madh të dorës së djathtë mbi treguesin — do të ta këpus kokën si të zogut!» Po ai djali që kishte ardhur atë ditë në brigadë pse i dilte përpara syve? Sa emër të bukur që kishte. Sadrit! Asaj i pëlqente të mendonte për të.

Dhe buzëqeshi në errësirë.

Rrezja e hënës qe ngjitur mbi mur e dukej aty si një pullë e verdhë. Vetëm vonë i erdhi gjumi. Në mëngjez, si zakonisht, u ngrit herët.

Kreu shpejt e shpejt disa punë shtëpiake dhe u nis për në arë. Ndjente në vete diçka të pakuptuar, që e mundonte.

Toka dhe qielli i përhimë dukeshin si të bashkuar. Ajo ecte në rrugë e vetëmuar. Nga lindja rrezet e para të diellit u derdhën mbi kodrat e Kasharit.

Kur u afrua Zelia, pa se aty përpara zyrave disa punëtorë diç lexonin te vendi i fletërrufeve. Sa më tepër afrohej aq më shumë rriteshin zërat dhe fjalët e atyre që flisnin. Por kur ajo kaloi pranë, zërat pothuaj heshtën e fjalët u prenë. Asaj nuk i bëri përshtypje kjo gjë. E shtyrë nga mendimi që të hante shpejt mëngjezin e të mos vonohej në punë, hyri në mensë, u ul në tryezë dhe filloi të hante. Lulieta u afrua dhe iu ul pranë.

— Si u gdhive, Zekë?

— Mirë, Lulieta, po ti? Moj, — vijoi mbas pak, — përse janë mbledhur punëtorët? Ç'lexojnë ashtu? Ndonjë fletërrufe?

— Po.

— Kë kanë vënë në shenjë kësaj radhe?

Shoqja që kish pranë u gëlltit e s'foli.

— Pse nuk flet Lulieta?

— ... Ajo fletërrufe është vënë për ty.

Ajo shtangu. Fytyra iu skuq e sytë filluan t'i vishen me një cipë të hollë. «Mua fletërrufe? Pse? Ç'kam bërë?»

La bukën në mes, u ngrit ngadalë e u drejtua te dera. Aty akoma kishte njerëz. Ajo u fut në mes të tyre e, duke mbajtur lotët me zor, mbërtheu sytë në letrën e shkruar. Në fillim s'mund të shquante dot gërmat. Por dalngadalë cipa e hollë, që i vishte sytë, u gris, u tret. Ja çfarë shkruhej në fletërrufe:

«Të drejtohem i ty, shoqja Zelië: pse rri e ndrojtur ndaj shokëve me të cilët punon? Pse nuk merr pjesë rregullisht në aktivitetet kulturalo-shoqërore? Pse pranon të nxish jetën tënde duke mos e prishur fejesën e lidhur që në femini? Ç'familje mendon të krijosh kështu? Pse nuk ngrihesh

t'i godasësh me forcë këto mbeturina? Mos vallë nuk e ke lexuar fjalimin programatik të 6 shkurtit të shokut Enver?

Në fund të fletërrufesë lexohej firma:

«Organizata e rinisë».

Çfarë ndjeu ajo ato çaste? Edhe vetë Zelian po ta pyesje s'do të qe në gjendje të thoshte diçka të saktë. Në fillim një gjë e hidhur i kaloi nëpër grykë, por duke lexuar më poshtë, sytë filluan t'i shkëlqenin dhe shija e hidhur iu largua menjëherë. U shkëput nga ata që lexonin, u veçua pak si mënjane dhe kuptoi se po forcohej. Tej, poshtë një lokomotivë vraponte nëpër shina. Në xhade qendroi një karrocë. Disa vullnetarë të hipur mbi maqinë këndonin. Ngjyra e qiellit po hapej e rrezet e diellit derdeshin më të zjarra, më të gëzuara. Sipërfaqja e përroit aty pranë shkëlqente. Mbi përrua fluturuan me cicërime dy zogj. Punëtorët dilnin nga magazina me vegla në duar e niseshin drejt kodrës me hardhi. Këto gjëra i kish parë gjithmonë, por kurrë nuk i kishin bërë kaq shumë përshtypje si atë mëngjez. I dukej vetja e lehtë, shumë e lehtë, si një grimcë ajri, sikur qe shndërruar në diçka të tejdukshme të paprekëshme, të gëzuar. Po ky qe vetëm një çast. Lulieta e nxori nga ajo gjendje. Ajo iu afrua dhe i vuri dorën në sup lehtë, sikur deshi t'i jepte zemër.

— Shokët ta kanë dashur gjithmonë të mirën — i tha.

— Sa mirë e the, Lulieta! — tha Zelia, që e mbloshi veten shpejt. — Edhe për mua fletërrufeja është e drejtë, po, shumë e drejtë.

— Motra ime! — tha Lulieta duke e shtrënguar

nga supi, kur pa se në sytë e shoqes, zakonisht të butë e të hutuar, shkëlqenin lotët.

— Ku është Ismaili? Dua të bisedoj me të.

— Shkoi me Sadritin. Ja, shiko, po i ngjiten vreshtit. Vrapojmë t'i arrijmë!

Të dyja u lëshuan me vrap. Disa punëtorë, që i panë të fluturonin si dy flutura, u çuditën. Zelia ishte aq e ngathët, aq e ndrojtur, e tani vraponte pa pikë frike.

— Ismail, o Ismail! — thirri Lulieta, ndërsa vraponin. — Ndaloni se na morët frymën!

Djemtë i pritën buzagaz.

— Hë, ç'kini që vraponi? Qënkeni ndezur si zjarr.

— Zelia do të bisedojë me ty, Ismail, — i tha Lulieta. — Prandaj erdhëm me vrap, se nuk na mori malli për ju! — Fjalët e fundit të hedhura me shaka, shkaktuan të qeshura te të katër të rinjtë. Qeshte dhe Zelia.

«Si u hapa kështu, mendonte ajo, si vaji në ujë. Po sikur të më shohë tata?»

— Hë Zelië, ç'do më thuash? — tha Ismaili, kur pushuan së qeshuri e u nisën lart. Dy vajzat ecnin në mes, ndërsa djemtë anash. Sadriti kishte Zelian në krah të majtë. Meqë rruga që e ngushtë, herë pas here ata takoheshin sup më sup. I dukej se diçka e butë, e ëmbël, e ngrohtë, i hynte nëpër trup e i ngatërrohej në gjak, sa herë ndjente të prekurit e supit të saj.

— Për fletërrufenë, Ismail, për këtë desha të bisedoja.

— Edhe unë me Sadritin për këtë gjë po flisja, kur na thirrët. Përgjigjjen duhet ta japësh me

shkrim. Por në ke ndonjë gjë tjetër, folë atëhere

— Jo, dua t'jua them më parë me gojë, dua të ta them ty dhe organizatës së rinisë. A do të më ndihmoni ju që e filluat këtë rrugë? A do të më ndihmoni?

Ishte aq e tronditur sa i kalonin mornica nëpër trup. Ishte hera e parë që fliste aq lirisht me dy djem për hallet e saj.

— Ti, Zelig, dyshon në ndihmën dhe dashurinë e shokëve? Dyshon në forcën e rinisë?

— Jo, por më duket pak e vështirë... Kam nevojë për përkrahje.

Në të njëjtën kohë thoshte me vete: «Qyqja unë! Si flas kështu? Ç'do të mendojnë për mua? Sa budallaqe jam! Po pse mos të flas? A s'janë shokët e mi këta? Po, do të flas! Jo vetëm këtu, por kudo! Tani që nisi, le të shkojë gjer në fund. Po tata? Po xhaja? Ata janë të egër, të ligj. Do të më rrahin. Unë budallaqja! E ç'do bëjnë ata dy veta, dy pleq kundër gjithë kësaj force të rinjsh? Fund i fundit unë kam ligjin e partisë me vete. Tata më ka thënë se, po dëgjoji një gjë të vogël, fare të vogël, do të më vrasë. Por a mund ta bëjë ai këtë gjë? Sigurisht që jo! Po, do të them të vërtetën, të dalë ku të dalë. Nuk jam e vetme! Pastaj tatën e tërheqin të tjerët për hunde. Edhe tata do ta kuptojë»

Të katër u ngjitën te tenda mbi kodër. Në verë këtu bëhej seleksionimi i rrushit, ndërsa në dimër fushin plehun kimik për ta mbrojtur nga shirat.

— Mendoj të bëjmë mbledhjen e organizatës së rinisë në pushimin e drekës dhe të shtrojmë çështjen se si mund ta ndihmojmë Zelian — tha Ismaili.

— Mirë — tha Lulieta.

Sadriti pohoi me kokë e s'foli. Ai vështronte me vëmendje vajzën, që kishte përbri. Fytyra e saj shkëlqente. Sa shumë kishte ndryshuar në ato pak minuta!

— Sot do të bëjmë plehërimin e gropave — tha brigadierja. Çdo grope i duhen hedhur njëzet kg. pleh. Arkat e lidhura në dy hunj duhen të mbushen plot. Si thoni, fillojmë?

Ata nisën punën, djemtë në një anë e vajzat në anën tjetër.

— Më duket se ke ndër mend të ma kalosh — tha Ismaili. — Pse u ndave? Unë s'të kam asnjë faj.

Lulieta vrapoi dhe zuri njëren anë të arkës, ndërsa Ismaili anën tjetër. Sadriti vështronte Zelian me vëmendje të përqëndruar. Donte t'i thoshte diçka që t'ja lehtësonte dhimbjen. Vajza ngriti sytë e saj të kaltërt e buzëqeshi çiltër. Në faqet e skuqura u formuan dy gropëza aq të vockëla sa në to mund të fusje gishtin e një fëmije. Sytë i qeshnin më shumë se buza. Ajo u ul dhe kapi njëren anë të arkës. Ai bëri të njëjtin veprim. Kur u afruan te grumbulli i plehut organik, Lulieta dhe Ismaili u larguan. Sadriti e mbushi arkën. Nga plehu ngrihej një fjollë e hollë avulli. Vreshti ziente nga zërat e punëtorëve. Disa krasisnin, të tjerë mblidhnin degët e prera të hardhive. Dikush hapte gropa e disa të tjerë sillnin hunjë. Vajza shikonte djalin e përkulur përpara saj.

Ata e ngritën arkën me pleh e u nisën tatëpjetë. Ai shihte pjesën e prapme të trupit të saj, shpatullat dhe qafën e derdhur; vështronte flokët e saj të verdhë që shndërisnin si fije ari nën rrezet

e diellit. Kur ngjiteshin lart, ajo vështronte trupin e mbushur të djaloshit, që përkulej me shkathtësi tek merrte tezgën. Nën trikon e zezë dukeshin kon- turet e muskujve. Ashtu në heshtje, bënte disa vaj- tje-ardhje. Që të dy kishin dëshirë të bisedonin, por asnjëri s'fliste. Ai ishte shumë i lirshëm me Luli- etën. Pse s'fliste edhe me Zelian ashtu? Jo, këtu ndryshonte puna.

Ndërsa zbrisnin poshtë, asaj i rrëshqiti këmba papritur në një gropë, humbi ekuilibrin dhe, pa e lëshuar tezgën, u mbështet me një pjesë të krahut më të. Krahu rrëshqiti dhe ajo u gërvisht nga një tel i bakërtë.

— U vrave? — pyeti ai menjëherë dhe lëshoi tezgën. Ai vrapoi ta ndihmonte. Nga krahu i çjerrë i rridhte gjak. Ai e kapi me të dy duart krahun e saj të bëshëm e të forcuar nga puna. Donte t'i ndal- te gjakun, por më kot. Atëhere djaloshi u kujtua për diçka. Nxori me të shpejtë paketën, prishi dy cigare e duhanin e pllakosi mbi krahun e çarë. E shtrëngoi fort me mendimin se duhani duhej të ngjeshej ca më shumë. Shtrëngimi i atyre duarve të forta e të mëdha i shkoi vajzës gjer në zemër. Ishte një shtrëngim lehtësonjës, që platiste çdo dhimbje. Sadriti nxori shaminë nga xhepi, njërin cep të së cilës e zuri me dhëmbë e cepin tjetër me dorë, si të donte ta shqyente.

— Mos! — tha ajo.

Ai, duke menduar se e lëndoi, pyeti:

— Çfarë?

— Mos e gris shaminë!

Sadriti tërhoqi dorën me fuqi e shamia u gris

në mes. Pa e ngritur kokën fare, ai ja lidhi dorën në heshtje.

Asaj i vinte kaq mirë nga gjithë ai kujdes.

— Ndjen më dhimbje? — pyeti, ndërsa i lëshoi krahun.

— Jo — tha ajo — falemnderit.

— A mund të punosh më?

— Po. Fillojmë.

Dhe nisën përsëri nga puna. Ajo ndodhi e vogël i afroi akoma më shumë dhe u dha rrugë të lirë mendimeve të saj.

— Pse heshtje gjatë rrugës? — tha Zelia. — Unë isha e gëzuar qëparë.

Ata shkarkuan arkën e u nisën përsëri lart.

— Mendoja për ty — tha ai.

— Shumë?

— Po, shumë.

— Sa? — tha ajo.

Sadritit iu kujtua fëminia. Atëhere ai ishte i vogël dhe e motra e pyeste:

— Më do mua?

— Po.

— Sa?

— Kaq! — e hapte krahët e vegjël.

— Aq pak?

— Sa mali!

— Jo më tepër?

— Sa deti!

— Kurse unë të dua shumë.

— Edhe unë të dua sa toka, sa qielli, sa deti, sa globi.

Dhe me fjalën glob, atëhere ai kuptonte gjithësinë. Qeshi i gëzuar nga ky kujtim dhe u përgjegj:

— Sa toka, sa qielli, sa deti.

Të dy qeshën. Dhe padashur ishin afruar shumë.
— Ehe — u dëgjua zëri i Lulietës, — luani këmbët, jua kaluam.

Ata të dy punonin në anën tjetër të ngastrës. Zëri i brigadieses tingëlloi qartë dhe iku tutje me erën që frynte mbi vreshtë.

— Do ta shohim në do të na e kaloni. Mos harro se ne jemi më të fortë. Mos u nxito — u përgjegj Sadriti. — Ja, edhe pak mbarojmë e do të vijmë t'ju ndihmojmë dhe juve. S'na pëlqen t'i lemë shokët prapa.

— Do ta shohim — u dëgjua përsëri zëri i brigadieses. Ajo i tha diçka Ismailit dhe ky qeshi me zë të fortë.

Zelia dhe Sadriti punuan duke shkëmbyer herë pas here ndonjë fjalë gjer sa ra çanga. Anëtarët e Bashkimit të rinisë, të lajmëruar për mbledhjen rrufe, hëngrën me të shpejtë dhe u mbledhën në një nga klasat ku zhvillonin mësimet punëtorët.

Ismaili qëndroi në këmbë pranë tryezës. Pa një herë rreth e qark, si të donte të kontrollonte në ishin të gjithë dhe tha:

— Dje pas dite u mbledhëm dhe bëmë një fletërrufe. Shoqja Zelia e sheh të drejtë fletërrufenë dhe na falënderon.

Ndërsa ai tha këto fjalë, dikush trokiti në derë. Ismaili u nis ta hapte. Të trokiturat u përsëritën akoma më të forta. Zelia, në fillim donte të ngrihej, por pastaj ndërroi mendje.

Dera u hap dhe Dullë Qylafi hyri brenda si furtunë.

— Ç'bëhet këtu? — pyeti me zë të egër.

— Qetësohu, Dullë, merre më shtruar. Si e

ke punën? — i tha Ismaili. — Pse je kaq i shqetësuar? Ç'ke?

— More, ç'bëhet këtu ju them? — tha ai dhe shtrëngoi rrofullat.

— Ti, Zelig, — iu drejtua së bijës, — eja me mua!

— Ajo është në mbledhjen e organizatës dhe, pa mbaruar mbledhja, s'mund të dalë — tha Sadriti.

— Ti mbylle gojën, mistrec! — thirri ai me inat. — Apo mos ke qejf ta lë time bijë të bredhë nga të dojë?

Kjo fjala e fundit ra si bombë. Një «uuaaa» habie e zgjatur u end nëpër dhomë. Zelia u zverdh. Sadriti mblodhi grushtet, ndërsa Luljeta u drodh. Të tjerët vështronin me neveri.

— Më shtruar, Dullë, të merremi vesh — tha Ismaili ngadalë duke e mbajtur veten për mrekulli. Ai është njeriu më i qetë në ato momente.

Atë çast u dëgjua zëri i fortë i një vajze, që u ngrit nga radhët e fundit e thirri me të madhe:

— Jashtë, nxirreni jashtë, jashtë!

— Jashtë, jashtë! — thirrën të gjithë.

Dullë Qylafi u trondit, u zverdh si dyllë. Hodhi një vështrim të hutuar rreth e qark. Fytyra të tendosura, sy që e shikonin me neveri e përbuzje, zëra që thërrisnin:

— Jashtë!

Në mes të tërë asaj rrëmuje u dëgjua zëri i fuqishëm i Sadritit:

— Shokë! — tha.

Kish ngritur dorën e djathtë dhe u bënte me shenjë që të pushonin. Zhurma u platit.

— Vëllezër e motra, — vijoi, — ky njeri e me-

riton të hidhet jashtë si një leckë, por unë jam i një mendimi tjetër. A është babai i Zelis? Le të rrijë e ta dëgjojë vetë fjalën e vajzës së tij.

— Po! — oshëtinë zërat në dhomë si një britmë e vetme, e fortë.

Dulla e pa veten ngushtë. Deshi të dilte, por kjo iu duk si jo e hijshme, jo burrërore. Ai kishte sedër. Vendosi të qëndronte. Sytë i nguli mbi të bijën si për ta kërcënuar që të mbyllte gojën e të mendohej mirë para se të fliste.

Po Zelia nuk vështronte andej.

— Shoqja Zelië, — filloi sekretari i organizatës së rinisë, mbasi u ul Sadriti, — si të duket fletërrufeja?

— Shumë e drejtë.

— Pse nuk ke marrë pjesë në aktivitetet e organizatës?

— Nuk më linte tata. — Ajo i drejtoi sytë nga i ati.

— Cilat janë arësyet?

— Pyeteni vetë.

— Shokët duan ta dëgjojnë nga goja jote. Prandaj jemi mbledhur sot këtu.

— Babai ka frikë se, duke shkuar kudo me rininë, duke ndenjtur midis djemve, do të gënjehem e do të humbas nderin, siç u shpreh ai pak më parë. Por në organizatën tonë të gjithë janë njerëz të mirë, të dashur, të sjellshëm e të ndershëm. — Ajo pushoi për një moment. Pastaj shqiptoi me zë të lartë:

— Tata, sa herë që i thosha të dilja ose të shkoja në ndonjë vend me shokët, ma priste shkurt: «Ç'të duhen ty këto gjëra? Rri se je mirë dhe ulte vetullat për të më treguar se duhej të bindesha.

Duke ndenjurr e vetëmuar, u ndava nga kolektivi. Vetëm tani e shoh se sa e madhe qenka shoqëria, sa e mirë! Ju mendoni për të mirën time dhe unë ju falënderoj e do të përpiqem që të bëj gjithshka e t'jua shpërblej.

Ajo fliste ndërsa të tjerët dëgjonin me vëmendje. Dulla e vështronte hidhur. Sadriti i kish ngulur sytë e herë pas here luante kokën në shenjë pohimi për t'i dhënë zemër. E shikonte dhe e ndjente se ajo po futej thellë në qënjen e tij. Për pak sekonda ra heshtje. Një heshtje e nderë. Të gjithë prisnin me ankth, të gjithë qenë të revoltuar nga fjalët e Dullës, e u vinte keq për Zelian.

— A e do të fejuarin? — pyeti Ismaili.

— Jo!

— Pse e pranove atëhere fejesën?

— Se mos më pyetën mua. Kur e mësova unë, gjithshka kish marrë fund.

— Domethënë u pajtove me veprimin e tyre.

— Po. Në familje nuk kisha as njeri që të më ndihmonte. Nëna më ka vdekur. S'mund t'i hapesha askujt e ndjeja gjithmonë frikë. Sa herë më dilte përpara ai, i fejuari im e më fliste, unë ikja menjëherë. Nuk e desha, nuk e dua! Kur ja thashë këtë Nuries, nuses së xhaxhait, ajo më tha: «Lëre, lëre»! Po si? as unë e as ajo nuk e gjenim dot rrugën e shpëtimit. Vetëmia na ndrydhte. Vetëm ju po më ndihmoni me të vërtetë. Të gjithë...

Ajo pushoi pak sikur donte të mblidhte mendimet, e pa një herë rrotull. Sytë e atyre që e rrethonin e shtynin të vazhdonte. Zemra iu përpëliti nga gëzimi e një buzëqeshje si rreze drite iu end në fytyrën e skuqur. Sadriti e shihte dhe i bëhej

qejfi që ajo po mbyste me duart e veta gjithshka të kalbur e të vjetër, që i rrëmbente gëzimin.

— Shokë, e jeni të gjithë të mendimit që të prishet kjo fejesë?

— Të prishet që këtë çast — thirrën të gjithë.

— Ç'thua ti? — iu drejtua Ismaili Dullës.

Sadriti i hodhi sytë nga Zelia te Dulla. Ky rrinte kokulur e dukej sikur ishte plakur shumë brenda atyre çasteve. Përpara të rinjve e ndjente veten shumë të dobët. Ndenji ca ashtu, pastaj u ngrit me tërbim:

— Jo, këtë nuk e pranoj. Ju ndaloj të fusni hundët aty ku nuk ju përket. Nuk ju lejoj të merreni me çështjet e familjes sime! Nuk ju lejoj!

— Kjo nuk të përket vetëm ty, — ja preu Ismaili, por edhe neve. Ti po dëgjon vetë se si jot bijë ngrihet kundër teje, sepse ti je streha ku fshihet fanatizmi. Kafshë ishte jot bijë që e shite pa e pyetur? Pse e torturon kështu?

Dulla vari kokën. U ul mbi bankë e nuk foli.

— Nuk flet, se nuk ke ç'të thuash. Ndaj hesht, hesht e mendon. Kjo gjë duhet të të vlejë.

Pastaj ai u kthye nga Zelia:

— Ti, Zelië, ç'thua, do të prishet fejesa?

Ajo u hutua. Vështronte rrotull. I ati rrinte atje kokulur dhe e shikonte me bisht të syrit.

— Pse ngurron? — i foli Lulieta dhe e kapi nga dora. — Ç'ke, folë!

Tjetra sikur u shkund nga ajo e prekur. Sytë i shkëlqenin si në ethe.

— Oh. Jo, shokë, heshtja ime nuk është ngurrim... Nuk ngurroj aspak, por them me të madhe: fejesa duhet prishur.

Zëri iu drodh. Sytë iu mbushën. Lotët i rrodhën nëpër faqe. U ul e zuri të qante pa zë. Lulieta i lëmonte flokët. Të tjerët e shikonin me keqardhje, me simpati e dashuri. Sadriti i shihte supet e mbushura, që dridheshin nën bluzën e zezë.

— Ti e dëgjove — iu drejtua Ismaili atij. — Jot bijë është kundër fejesës. Po nuk e pranove në shtëpi, ne nuk e lëmë rrugës, ja gjejmë vendin.

— Të vijë tek unë! — tha Fatimja nga fundi i sallës.

— Jo, tek unë — tha Lulieta.

— Tek unë!

— Tek unë!

— Tek unë!

Vetëm Sadriti s'foli. Ai ndiqte me sy lëvizjet e Dullës, mimikën e tij e cila ndryshonte çdo çast. Kur e shihje, të vinte keq.

Ai u ngrit më këmbë.

— Jo, jo, ajo do të vijë në shtëpi. Në fund të fundit është goca ime. Si mund ta lë unë gocën time?

U afrova te vajza, ja mori dorën. Ajo iu hodh në grykë dhe e përqafoi sikur donte t'i thosh të mos i mbante mëri. Sadriti, që ndodhej aty pranë, pa se Dulla ishte prekur me të vërtetë. «Edhe ky po thyhet, po thyhet!»

III

Mbas dy javësh, drejtorja e fermës «Gjergj Dimitrov» organizoi një takim të madh me të rinjtë e sektorëve të ndryshëm të fermës për shkëmbim përvoje dhe mendimesh. Nga brigada e Lulietës në ta-

kim do të merrnin pjesë: Luljeta, Ismaili, Sadriti, Nuria, Bukuria dhe Zelia.

Sadriti atë ditë, që ndodhi e shtunë, u ngrit shpejt, bëri disa lëvizje gjimnastikore, u vesh e hap radion. Ngrohu në furnellë çajin për babanë që do të kthehej nga puna dhe pa vëllanë më të vogël, Agimin, që flinte si shqerrë. Ndërsa po hante, dëgjonte muzikë. Mendja i shkoi te aktivi i rinisë. Iu kujtua se, kur ishte caktuar Nuria për në aktiv, Rremë Qylafi e sulmoi me fjalët më të ashpra. Nurries nuk iu durua dhe ja ktheu.

— Ç'të duhet ty nga shkoj unë? Apo mos i kujton të gjithë njerëzit si veten?

Tek po mendonte kështu, u hap dera dhe hyri babai, një burrë i gjatë e i mbushur, i cili, si u përshëndet, hoqi pallton dhe vari pushkën.

— A u lodhe, baba, — tha Sadriti dhe u ngrit nga vendi, — si kalove mbrëmë? Të mori ndonjë cikë gjumi?

— Jo, biro. Ne pleqtë flemë pak. Duam t'i marrim jetës sa më shumë kohë, sepse e dimë që vdekjen nuk e kemi larg. Po ti si fjete?

Djali i vuri përpara mëngjezin.

Ai zuri të hante. Pas pak nisi muhabeti i zakonshëm.

— A s'do që më mirë, mor bir, sikur në vendin tënd, të gjeja nusen në shtëpi? A s'do që kënaqësi që të përkëdhelja e të puthja nipër e mbesa? — tha ai.

— Nuk e ke keq, baba. Do të përpiqem të mos jetë larg ajo ditë.

Plaku e shikoi të birin dhe i tha:

— E paske vendosur?

— Akoma jo. Por, e di? Më pëlqen një vajzë?

— Po cila është, mor bir?

— Ti nuk e njeh, baba. Ajo e ka shtëpinë larg, mbrapa qafës së Kasharit. Por të atin, Dull Qylafin, më duket se e njeh.

Plaku mori gotën e çajit e filloi të hante në heshtje. Sadriti priste. Babai tha:

— Vajzën nuk e njoh, po Dulla s'më duket ndonjë burrë i mirë.

— Ti vetë më ke thënë, baba, se edhe nga ferra mbin trandafili — tha Sadriti duke qeshur.

— Në ke vendosur, djalo, hair u bëftë. Veç duhet pasur kujdes në këto gjëra. Njeriu një herë martohet.

— Mos ki merak. Ajo është vajzë e mirë. Sot do shkoj në Tiranë se kemi mbledhje. Atje do jetë edhe ajo. Shpresoj të bisedoj me të gjerë e gjatë. Ditën e mirë, baba!

Doli. Thithi fort ajrin e freskët, që dridhej nga era e nxitoi për te autobusi.

Mbas pak autobusi erdhi. U ngjiti. Atje ishin të gjithë. Sadriti i përshëndeti me radhë. Vështrimi tij ndeshej herë-herë në sytë e kaltërt, me qerpikë të zez, dhe ai i nënqeshte asaj lehtë, shumë lehtë thua se kishte frikë se të tjerët do ta kuptonin atë që i ziente në shpirt.

Përpara pallatit të madh të kulturës ishin mbledhur të rinj nga Marikaji e nga Lundra, nga Kashari dhe Shkoza, nga Sauku dhe Babrruja. Ata ishin të qeshur. Bisedonin me gjallëri për probleme të ndryshme, rrihnin tema mbi punën dhe pothuajse të gjithë ndjenin një farë emocioni.

Drita e ngrohtë e diellit, bukuria e qytetit, gjallëria e të rinjve, të gjitha këto i lanë Sadritit për-

shtypjen sikur pranvera kishte ardhur para kohe. Pas pak, të gjithë u futën në pallat. Në presidium zunë vend drejtori i fermës, një burrë eshtak me fytyrë të vrarë nga lia, një i deleguar i Komitetit të Rinisë si dhe shoqe e shokë të tjerë punëtorë të thjeshtë, kultivonjës të rrushit e të pjeshkës, të mis-rit, të ullirit e të shumë kultuarve të tjera bujqësore.

Fjalën e mori sekretari i partisë. Ai foli mbi rolin e madh të rinisë në ndërtimin e jetës së re socialiste.

Pastaj filluan diskutimet. Shumë të reja e të rinj dilyn e flisnin. Jepnin mendimet e tyre për punën dhe u tregonin të tjerëve se ç'forma përdor- nin për të marrë sa më shumë prodhim.

Sadriti vari re me gëzim një forcë të pashoqe në fjalën e tyre, pa se ç'të rinj të mrekullueshëm kish ferma, ku ai punonte e jetonte, me sa bindje flisnin për të ardhmen, si do ta ndërtonin atë, si do të zhduknin gjithshka, që do t'u dilte nëpër këmbë e do t'i pengonte.

Deshi të thosh edhe ai mendimet e veta, ndaj shkroi një pusullë të cilën e nisi në presidium. Në të shënoi: «Dua të them dhe unë fjalën time në këtë aktiv të madh. Sadrit Shpata. Sektori Kasha-rit». Kur shokët e presidiumit e morën pusullën, sikur u pendua pak. Nuk ishte përgatitur për të folur. Po sikur të ngatërrohej e t'i merrej goja? Po sikur ta humbiste e të mos thoshte asgjë? Sa turp do të qe! Të gjithë do ta merrnin për guak. Por ai e vendosi: «Unë do të flas, do të them atë që mendoj».

Pas pushimit diskutimet vazhduan. Ai priste radhën. Më në fund drejtori tha:

— Fjalën e ka shoku Sadrit Shpata, punëtor në sektorin e Kasharit.

Sadriti u ngrit nga vendi. Një ngjyrë e kuqe i ra në fytyrë. U ngjit në podium. Nuk guxonte t'i ngrinte sytë nga frika. Ai pa përpara tij sallën e mbushur me fytyra të qeshura dhe iu duk sikur salla ishte plot me shokë të njohur. Qindra sy e vështronin dhe prisnin ç'do të thoshte. Ai mbështeti duart përpara, ngriti pak kokën dhe filloi. Fjala e tij ishte ca e rëmbyer në fillim. Ai fliste shpejt, sikur të kishte frikë se, po të ndalej, do t'i merrej goja e nuk do të thoshte më asnjë fjalë. Pas pak heshti dhe vuri re se të gjithë po e dëgjonin me vëmendje. Kjo i dha zemër dhe vazhdoi të theksonte se pa kulturë nuk mund të ngrihet socializmi, pa kulturë nuk bëhet asgjë.

Fjalët i theksonte me një ton që shprehte vendosmëri e bindje të plotë.

Duartrokitje të forta shpërthyen në sallë. Salla i buzëqeshte. U largua nga podiumi e i dukej sikur ecte mbi duartrokitje. Shkoi në vendin e vet dhe u ul. Nxori shaminë dhe fshiu djersët, që i kishin mbuluar fytyrën. Bënte vapë. Dikush tjetër po fliste. Zelia, e ulur pranë, e kapi nga dora dhe i pëshpëriti: «Sa mirë fole!» Disa të rinj që i kish pranë dhe s'e njihnin e shikonin me kureshtje. Ismaili, Luljeta dhe Nuria e uronin me sy. Ai u buzëqeshi.

Mbi yllin e sahatit që dukej midis dritares së hapur fluturonin zogj. Ora kish shkuar dymbëdhjetë. Ai hodhi sytë nga dritarja e pa, pak më tej, monumentin e Skënderbeut. Aty nga ora tre, mbledhja u mbyll. Mbas hëngrën drekë të rinjtë, ashtu të bashkuar, shkuan në cirk.

Po atë mbrëmje Dullë e Rremë Qylafi ishin ulur pranë zjarrit e, ndërsa ngroheshin, i qanin hallet njëri-tjetrit.

— Secili ka telashet e veta, or Dullë. Me këto kohëra që kanë ardhur është bela e madhe të kesh fëmijë, e le pastaj vajza.

— Lëre, vëlla. mos e ngit. — tha tjetri. — Unë një kam. Po më luan mendja se mos më turpëron me ndokënd, se dreqi që na mori pastaj...

Rrema qeshi nën buzë. Flaka e zjarrit i ndriçoi kokën tullace e rrudhat e fytyrës. Sytë i ndrisnin me djallëzi.

— Kanë hakë, or Dullë, gjersa u ecën, qindin le të bëjnë. E kujt nuk i pëlqen të bredhë me goca? Të gjithë, bile edhe ti do të doje t'i kishe pranë dhe, po të mundje, t'u ngulje edhe dhëmbët.

— Ah, — u hodh Dulla, — dhëmbët e mi janë krimbur — dhe qeshi hidhur.

— E, megjithatë, qejfi ta ka.

— Ç'flet ashtu, o Rremë. Ne u plakëm tani. Turp, besa.

— Unë flas açik. — tha Rrema. — Femrat na pëlqejnë të gjithëve. Dhe s'ka femër që të mos bjerë në dorë, po të dish t'i sillesh rrotull.

Nga dritarja e hapur erdhi deri tek ata e qara e një fëmije. Rrema ngriti veshët.

— Edhe ky byrazeri ynë si shumë po i beson asaj Nuries. Gati sa s'bie në gjunjë përpara saj.

Rrema u koll e trazoi zjarrin me mashë. Pas pak shtoi: — Më vjen shumë keq për tim vëlla se po i vënë brirë.

— Mos folë kot.

— Unë s'flas kurrë kot.

- Me cilin atëhere, thuaje troç?! —
- Nuk mund të them, po me ç'duken bathët... —
- Mos folë kot, or Rremë! — thirri ai. —

Mjaft me këto...

— Kur e do plot ti, or Dullë? Apo kur ta sjellin në prak me viç?

— Pse flet kështu? Mos do të thuash se edhe Zelia...

— Epo njësoj janë të dyja, femër ajo, femër kjo. Po nuk ua mblodhe, të marrin nëpër këmbë...

Dulla uli vetullat dhe u drodh kur mendoi se e bija mund të shkonte me djem dhe se mund ta turpëronte. Hodhi sytë nga dritarja. Qielli po errej. Nata po afrohej e ngathët. Hodhi sytë nga rruga. Asgjë nuk dukej andej, veç një qerre, që largohej tërhequr nga një pendë qe.

«Dreqi e mori, ç'm'u desh mua ta lija?» tha me vete. I hyri merak në tru e në trup dhe nuk i shqitej. Dyshimi i lëvrinte në gjak e s'gjente qetësi. Rrema nxori kutinë e duhanit dhe ja hodhi të vëllait përpara.

— Ma bëj ti — i tha Dulla. Duart i dridheshin.

Rrema ja drodhi cigaren dhe ja ndezi.

— Mos harro, vëlla, se femra është si qeni, e llastove, të hypi në qafë, i tregove drunë, zë e të tund bishtin e të fërkohet. Po ta them edhe një herë; kanë ardhur kohëra të këqia. — dhe bëri të ngrihej.

— Bëfsh natën e mirë — tha Rrema.

Dulla nuk i dha përgjigje e nuk lëvizi nga vendi. Nëpër dritaren e hapur u dëgjua përsëri e qara e fëmijës që priste nënën. Po këtë radhë Dulla nuk e dëgjoi. Mendimet e turbullta ja kishin zënë sytë e veshët.

Ra të flinte po gjumi nuk e merrte. E nguli shikimin në tavanin që ndritte nga drita e zjarrit dhe priti të bijën.

«Sa i marrë që jam! mendonte, se mos është e vogël ajo. E si të bëhet e keqe me shoqe si Lulieta e Bukuria? Vërtet Rrema ka mend, po edhe e shkel nganjëherë ama.»

S'vonoi shumë dhe ajo erdhi. Hyri lehtë që të mos i prishte qetësinë të atit. Ajo kujtonte se ai flinte. U afrua te llamba, ngriti fitilin e dhoma u mbush me dritë.

— Erdhe? — u dëgjua zëri i Dullës.

— Tani sa erdha. Nuk fle?

— Më nxore gjumin — tha ai.

— Ke rënë shpejt, tatë?

— Po, s'kisha ç'të bëja.

— Po shkoj të fle dhe unë.

— Ha bukë një herë.

— Nuk më hahet.

— Groshët janë në vorbë. Por edhe unë s'hëngra.

— Pse?

— Kot, s'më hahej.

Ajo mori llambën në dorë e deshi të kalonte në dhomën tjetër.

— Si kaluat në Tiranë? — pyeti ai.

Zelia u ndal në mes të dhomës. U gëzua që i ati e pyeti për punët e saj. S'e kishte bërë kurrë këtë gjë.

— Shumë mirë. Pamë edhe cirk. S'kisha parë asnjëherë cirk. Sa gjëra të bukura ka në Tiranë! Mbas cirkut shkuam në «Vollga». Kështu i thoshin atij lokalit, ku hymë e u ulëm të gjithë bashkë në-

për tryeza. Po unë s'piva. Shishet e birrës ua dhashë Sadritit e Ismailit... — Sikur vajza të shihte se si u thartua i ati në fytyrë, kur dëgjoi emrin e Sadritit, do kish pushuar menjëherë. Por e shtynte dëshira që të fliste për atë djalë aq të mirë dhe i lëshonte fjalët lirisht. Ajo kënaqej që Dulla e dëgjonte.

— Me një fjalë, kaluam mirë, aty kish orkestër, muzikë. Të gjithë u ngritën dhe kërcyen. Mua më erdhi keq, po s'dija të kërcëja. Oh, u kënaqa, tatë! Po Sadriti? Sa bukur foli Sadriti...

— Mjaft — shfryu Dulla — shko e fli!

Vajza, e prekur nga ndryshimi i menjëhershëm, uli kokën e kaloi matanë. Por shumë shpejt e harroi të atin. U rrëmbye nga bota e ëndrrave, nga ngjarjet e ditës. I kujtoi të gjitha. E më shumë i pëlqente të mendonte për Sadritin.

IV

Zelia edhe atë mëngjez doli nga shtëpia me shpirt të lehtë si zakonisht. Ecte rrugës e fytyra i ndriste. Ngriti sytë e pa qiellin qelq. Sikur nuk ishte dimër atë ditë. Vetëm aty përmbi Dajt, disa re të vogla e të holla, shumë të holla, po ndërronin ngjyrë nga të përhime në të bakërta. Vajza e ndoqi me sy ndryshimin e ngjyrave gjersa ato u bënë të kuqe. Pastaj doli dielli e nga retë s'mbeti më asgjë.

Rrezet e diellit ranë edhe mbi kodrat e Kasharit, ranë mbi rrugën, ku kalonte Zelia, dhe sytë e saj u fshehën nën qerpikët e gjatë, që filluan të puliteshin me hijeshi. Aty rrotull nuk dukej njeri.

Tej, nga fundi i rrugës, po afrohej një grup njerëzish. Ata ishin larg dhe ajo nuk i shquante dot.

«Nuk di, mendonte ajo, pse këto ditë jam bërë si tjetër njeri, nuk më rrihet më vetëm si një canakuq nër ferra. Më pëlqen të jem me shokë e shoqe, të punoj e të këndoj me ta. Sa budallaqe që jam! Ç'po mendoj kështu? Pse, a nuk jam e lirë? Kush më ndalon? Unë duhet të gëzoj të gjitha liritë e të drejtat që u ka dhënë partia gocave shqiptare. Unë ja thashë në sy tatës ato që mendoja dhe, me ç'po shoh, ndryshe sillet tani. Ja, ai nuk më ndaloj, ashtu siç e kishte zakon, të shkoja në aktiv të rinisë. Sa bukur që kaluam aty, sa gjëra mësova prej atyre vajzave të reja e të thjeshta, që u ngritën e folën, si Sadriti, aq lirisht e pastër sikur të m'i njihnin mendimet, sikur t'i lexonin në trurin tim. Sikur të flisja edhe unë, të njëjtat gjëra do thosha».

Vreshtat flinin. Midis tyre akoma s'kish hyrë njeri. Fijet e barit në anë të rrugës, ku kalonte vajza, mbanin mbi majat e tyre pika të vogla vese që ndriçonin si grimca kristali nën rrezet e diellit.

Ajo ndjeu hapa pas. Dikush po i afrohej. U kthye dhe e pa. Zemra zuri t'i rrihte më shpejt. Ishte Zyberi. Vajza shpejtoi këmbët, por dhe hapat nga pas nuk i ndaheshin. Ç'deshi ai aty? I ra rruga andej apo po priste me kast?

— Zelig! — dëgjoi zërin e atij që e ndiqte.

Ajo shpejtoi më shumë.

— Zelig, ndalu, të them! Dëgjon apo jo?

«Nuk ndalem, nuk ndalem,» mendonte, ndër-sa shpejtonte e sytë i mbante poshtë. «Po pse të mos ndalem? Pse të mos i them se nuk e dua? Pse ta mbaj me shpresa? Le ta heqë nga mendja, unë nuk do të bëhem kurrë gruaja e tij!»

Dhe u ndal në një kohë kur ai nuk e priste. Zybereri u ndal pranë saj. Me zor merrte frymë.

Heshtje.

— Ç'do? — pyeti ajo? — ç'do nga unë?

Ai e shikonte në sy me egërsi dhe lutje njëkohsisht. S'dinte si të sillej. U mundua të qeshte.

— Unë të dua, Zelia. Përse më pret kështu me këmbët e para?

Ajo uli kokën e vijoi rrugën.

— Unë e di se një ditë do bëhesh gruaja ime, por kam dëgjuar se...

Fërkonte duart, lëviste në vend i shqetësuar e hidhte sytë sa andej këndeje.

— Çfarë ke dëgjuar? — i tha ashpër Zelia.

Por pastaj ndërroi mendim.

«Pse të mos bisedoj lirisht me të? Do t'i them se nuk dua e ai do të më lërë rehat pastaj. Kjo gjë ka marrë fund».

— Ne jemi nga një fshat — tha Zybereri. — Ti më njeh shumë mirë.

— Nuk është e vërtetë — u përgjegj vajza. — Unë vetëm të kam parë, por ne kemi qenë gjithmonë të huaj për njëri - tjetrin. Nuk kemi biseduar kurrë, kështu që...

Por ai ja preu fjalën:

— Mos u mërzit, do më njohësh. Ti do bëhesh gruaja ime...

— Jo, unë s'do të bëhem kurrë gruaja jote.

— Fjala është fjalë, zakoni zakon. Ti ke tatë dhe xhajë. Mendohu mirë.

— ... Ti the se më do? — ja preu vajza.

— Po, të dua.

— Pse më kanose atëhere?

— Po të më tradhëtosh...

— Unë s'të kam dhënë ndonjë fjalë.

— Kanë dhënë të tjerët.

— Ti ke motër?

— Kam.

— Do ta martoje me një njeri që ajo nuk e do?

— Po qe se do t'i kisha dhënë fjalën...

— Dëgjo këtu — tha ajo — unë nuk kam gjë me ty, mbase je djalë i mirë, por unë nuk ndjej asgjë për ty.

— Ndjen, s'ndjen, ti je gruaja ime — tha ai i nxehur.

— Të lutem largohu nga unë — tha ajo, largohu!

Priste që ai ta godiste, por djali qeshi si me tallje.

— Shih, shih, që kur qenke bërë kaq e vendosur? Apo që kur njohe atë horrin, Sadritin?

— ...

— Ì thua se do t'ja rregulloj unë samarin — thirri Zyberi.

U dëgjuan zëra. Njerëzit që Zelia kishte parë nga larg i ishin afruar. Ata mbanin në duar kablllo elektrike. Ecnin, flisnin dhe qeshnin. Zyberi u largua.

Punëtorët u afruan shumë. Ata qeshnin e flisnin me zë të lartë. Midis tyre ishin edhe dy vajza të veshura me pantallona, që dukeshin të lehta, të shkathta.

— Mirë mëngjezi! — tha një punëtor i ri.

Zelia ja ktheu përshëndetjen pa u ndalur. Një punëtor tjetër i moshuar, me fytyrë të rrudhur e flokë të thinjur, e pyeti:

— Nga ky fshat je ti?

— Po.
— Keni drita?
— Kemi.
— Të gjithë?
— Disa shtëpi akoma s'kanë marrë — tha ajo.
— Sa shtëpi janë? — e pyeti një nga vajzat
të veshura me pantallona.

— Shtatë a tetë.
— Sa keq — tha djali i ri. — Pse kanë mbetur
deri tani?

— Disa shtëpi janë larg — tha Zelia si e tur-
përuar. — Pastaj ka pleq që mazallah se heqin
dorë nga llamba.

— Edhe pleqve do t'ua mbushim mendjen. Do
të vëmë dritë, kudo dritë! Kjo është fjala e partisë
— tha burri.

— Sa mirë — tha Zelia e sytë i ndritnin.

Ata njerëz i pëlqyen. Ishin të çiltër, të dashur,
të mirë. Kish edhe vajza, vajza të veshura me pan-
tallona. Zelia shpejtoi hapat. Era e ftohtë e asaj
dite shkurti ja merrte cepat e shamisë.

Atë ditë nuk punoi me Sadritin. Ai me disa
shokë hapnin gropa. Qenë larg, në gjirin e Kodrës.

Mezi priste të mbaronte punën. Kur u nda nga
shoqet me të cilat punoi gjithë ditën, mori me të
shpejtë rrugën e fshatit. Kishte dëshirë t'i shihte
elektricitët, të bisedonte me ta, sidomos me vajzat.

Ecte dhe mendonte për vullnetarët.

Me të shkuar në shtëpi, pa dhomën që ndri-
çonte, pa llambën elektrike, që qeshte në tavan, pa
edhe llambën e vajgurit, llambën që s'do të ndizej
më kurrë, por elektricitët nuk ishin. E pyeti të
atin:

— Ku janë vullnetarët?

Plaku uli vetullat.

— Cilët vullnetarë?

— Ata, elektrikistët.

— Ikën — tha ai.

Ajo u prek nga përgjegja e të atit.

— Pse flet ashtu, tatë? Ata na sollën dritën.

— Mirë, mirë! U lumtë — tha Dulla por zemrën e kishte të thyer. Ishte në merak për vajzën e kjo nuk e linte t'i gëzohej asaj copëzë dielli që punëtorët ja montuan në tavanin e shtëpisë.

— Ku shkuan elektrikistët? — pyeti ajo përsëri.

— Ikën në fshatrat e tjerë.

Ajo kaloi në dhomën tjetër. Gjeti çelësin, e preku, e rrotulloi kraf dhe... dritë.

Po atë ditë Rrema, ndërsa mbante pleh me karrocë, pa Zyberin prej së largu dhe i thirri. Pasi shtrënguan duart, Rrema e pyeti:

— Si i ke punët?

— Keq!

— Pse?

— Mbesa jote s'po më del e besës.

Tjetri sikur u gëzua.

— Edhe unë për këtë të thirra. Po nga e di ti se s'të do?

— Fola me të sot në mëngjez.

— Ashtu?!

— Po. Ma preu shkurt. Si i bëhet kësaj pune, Remë?

Rrema e pa në sy. Fërkoi dorën e djathtë mbas faqes së parruar e u mendua gjatë sikur do të thosh-te ndonjë fjalë të madhe.

— Vetëm mjekra e qoses nuk rregullohet.

— Si?

— A ke menduar ndonjëherë se cili i ka fajet për këto?

— Po. Ai djali, Sadriti. S'më pëlqen ai njeri.

Qetë rrinin pa lëvizur e prisnin urdhërin e të zot. Mbi karrocë ngrihej avull. Mbasdita ishte thyer e dielli po i afrohej perëndimit.

— Pikës i ke rënë. Prej tij vijnë gjithë të këqiat, — tha Rrema.

— Si t'ja bëj, Rremë, mësomë, ndihmomë! Do të ta shpërblej, kurrë s'do të ta harroj të mirën që po më bën, — thoshte Zyberi sikur i lutej.

— Oh, jo, jo, nuk bëj asgjë me shpërblim. Të kam thënë një herë mik e të kam mik. Kësaj sëmundje i gjendet ilaçi vetëm...

— Si?

— Ti je djalë i fortë. Përpiqu ta bindësh, ta detyrosh atë tjetrin... Si e quajnë? — pyeti enkas Rrema, sikur s'ja dinte emrin.

— Sadrit...

— Hë. Sadritin. Ne nuk e dimë me siguri në e do ai, por një gjë dihet mirë, asaj i pëlqen djali. Hekuri duhet rrahur sa është i nxehët. Ai djalë të ka zënë rrugën, ai do të të marrë gruan. A mund ta durosh ti këtë gjë? Folë!

Zyberi shtrëngonte dhëmbët.

— Si t'ja bëj?

— Ta detyrosh që të heqë dorë, në mos me të mirë, atëhere me të keq: dajaku ka dalë nga xhëneti, mor lalë.

— Po. Ashtu do të bëj. Gruan time nuk ja lë atij. Natën e mirë!

— Të mirë e bëfsh — tha Rrema dhe u foli qeve që u nisën me hapa të ngathta.

Zyberi, duke ecur, egërsohej gjithnjë e më tepër. Tmerrohej kur mendonte se Zelia nuk do të bëhej gruaja e tij.

«Do ta kap Sadritin, do të flas me të e, po s'më dëgjoi, do t'i jap një dru të mirë. Ku është parë kjo? Vjen tjetri e, si pa gjë të keqe, të rrëmben atë që do të bëhet gruaja jote! Ku është parë kjo?» Kështu arësjetonte me vete duke shpejtuar hapat.

Ditët filluan të ngrohen. Erdhi prilli. Luleshqerrat buisnin nga toka e bari po përtërihej. Hardhitë lëngëzoheshin.

Në katundin e ri, kështu e quanin fashtin ku Sadriti kishte shtëpinë, erdhën dallëndyshet e para.

Një mbrëmje në sektor do të shfaqej një film dokumentar. Mbasi dorëzuan veglat e punës në magazinë, Sadriti u tha Lulietës dhe Ismailit:

— Sonte do të shfaqet një film i bukur. Shkojmë dhe ne?

— Shkojmë — tha Luljeta.

Ismaili pohoi me kokë.

— Po ti, Zelië, ç'thua? — pyeti Sadriti.

— Edhe unë do të vij — tha vajza, — por...

— Çfarë? — u hodh djali duke pasur frikë se do të nxirrte ndonjë pengesë.

— Mendoj të vemi të gjithë të organizuar.

— Shumë mirë — pohoi Luljeta.

— Ç'thua ti, Nurie? — pyeti Ismaili.

— Do vija me gjithë qejf, po e kam djalin të sëmurë. Më vjen keq që po ndahem nga shokët.

— S'ka gjë, shkojmë herë tjetër bashkë — iu përgjegj Luljeta.

— Po mua kush do më përcjellë? — pyeti Zelia.

— Unë me Ismailin — tha Luljeta.

— Edhe unë — tha Sadriti.

— Ndërsa unë — u hodh Nuria — do t'i lajmërojmë në shtëpi se kur do të kthehesh.

Sadriti u foli disa të rinjve që po afroheshin.

— Ejani, nxitoni, po kalon koha! A do të vini në film?

— Po — thanë ata që po afroheshin.

— Edhe ti, Fatime, edhe ti Bukuroshe? Po ti, Ali?

— Të gjithë do të vijmë.

— Atëhere nisemi. Duhet të ecim gjysmë ore.

— Natën e mirë! — tha Nuria.

— Natën e mirë!

— Natën e mirë!..

U nisën.

Ecnin grumbull.

— Si dolët sot me normën? — pyeti Fatimja.

— Grupi ynë e plotësoi dhe e tejkaloj — tha Luljeta.

— Edhe yni e plotësoi dhe e tejkaloj — u hodh Sadriti.

— Ndërsa grupi ynë, që ishte në tokë të vesh-tirë, vetëm sa e plotësoi — vazhdoi Bukuria.

— E po mirë, s'jemi keq.

Dielli u fsheh mbas maleve. Perëndimi mori ngjyrën e bakrit. Një kamion kaloi me shpejtësi dhe të rinjtë i hapën rrugë duke thirrur.

— I çmendur! — tha Fatimja për shoferin — Sa shpejt ecën.

— Kushedi si e ka punën. Nuk e pe si i binte borisë dhe kish ndezur dritat?

— Ndoshta ka pasur ndonjë urgjencë.

— Me siguri.

— A këndojmë? — propozoi Luljeta.

— Këndojmë — thirrën të tjerët.

Sadriti ja filloi me zë të fortë:

«Në ara, fabrika, kantiere,

Sot kanga dhe puna ushton...»

Kënga u nde e fortë përmbi xhade, mbi fushat e mbi plepat, që kishin filluar të hapnin sythet. Zelia këndonte me një zë të hollë e të ëmbël, që ai e shquante midis zërave të tjerë.

Disa dëgjonin në heshtje, ndërsa fytyrat u ndrisnin nga gëzimi. Kur pa se shokët s'po e ndiqnin, Zelia uli zërin dhe deshi të pushonte, po Luljeta i foli:

— Jepi, vazhdo, pse e ndërpret?!

Atëhere vajza ngriti zërin me forcë.

Të tjerët e pasuan:

« Të etshëm armiqt kombëtarë...»

Kënga fluturonte nga xhadeja e arrinte deri përpara sallës së mbledhjeve, ku do të shfaqej filmi. Ata që qenë mbledhur aty, dëgjonin e s'flisnin.

— Ah, të isha dhe një herë i ri! — tha një plak i thinjur.

— Ç'do të bëje? — e pyeti një i ri.

— Do të kënaqesha — tha plaku i çuditur nga ajo pyetje.

— Do bëje satelit — tha djali i ri.

— Tyt, mor pizeveng, pse, vetëm ata që bëjnë satelitë u kënaqkan?

— Po cilët kënaqen më shumë?

— Ata që punojnë e jetojnë si njerëz.

- Nuk e ke keq.
- Përse e pushuan këngën?
- Dhe vërtet kënga heshti. Ata u dukën në kthesën ku ndahej rruga kryesore.
- Do t'ju jap një lajm — tha Aliu.
- Të mirë a të keq? — pyeti Bukuria.
- Si t'ju them...
- Thuaje — e nxiti Luljeta — Po qe se na intereson, ne duhet ta dimë.
- Po, thuaje!
- Thuaje, pra! — s'iu durua Fatimes pa folur.
- Nuk u ke treguar ti, Ismail?
- Akoma jo.
- Po flisni, pra, ç'ka ndodhur? — pyeti Sadriti.

— Këto ditë... Ismaili shkon ushtar.

— Si?! — pyetën të gjithë në një gojë.

— Po. Sot më erdhi fletëthirrja — tha Ismaili. —

Më 25 të këtij muaji duhet të nisem.

Luljeta, duke përfituar nga muzgu, e kapi për gishtash dhe e shtrëngoi fort. Ai iu përgjegj atij shtrëngimi.

— Domethënë mbas pesëmbëdhjetë ditësh — tha Sadriti.

Zelia s'fliste. Ajo mendonte për Lulietën. Tani që dashuronte vetë, e dinte sa të vështirë do ta kishte. S'dinte ç'të thosh.

— Të shkosh e të vish shëndoshë, Ismail! Ne kemi besim se do ta kryesh me nder detyrën.

— Ju falem nderit.

As Luljeta s'fliste. Ajo vetëm i shtrëngonte gishtërinjtë me kallo. Kallot e tij puthnin kallot e saj. E donte shumë Ismailin, këtë ja pat thënë sa

e sa herë, por atë mbrëmje, sepse i dukej më i madh, më i shtrenjtë, më i fortë.

Ndërkaq arritën te ndërtesa dykatëshe. Poshtë ajo shërbente si mensë, ndërsa lart, atje ku do të shfaqej filmi, ishte salla e mbledhjeve. Hynë brenda e zunë vendet me radhë, njëri përkrah tjetrit, Aliu, Fatimja, Bukuria, Ismaili, Luljeta, Zelia, Sadriti e të tjerë mbas tij. Dritat u shuan e filmi filloi. Herë mbas here kur në ekran dilnin fytyra që populli i dënonte, ndonjëri nga salla thoshte:

— Ah, qen i qenit!

— I poshtër!

— Qetësi!

— Pushoni. Keni ardhur për film apo për llafe?

Qetësia vendosej. Po mbas pak dëgjohej ndonjë fjalë tjetër. Ishte një dokumentar, i cili demaskonte martesat me shitblerje. Njerëzit nuk rrinin dot të qetë.

Kur filmi mbaroi, ata zunë të dilnin. Sadritit i zinte veshi fragmente bisedash:

— Mirë e gjetën.

— Ç'kërkuan, morën.

— Ai maskarai kishte dhe armë.

— Dhe e kërcënonte të bijën.

— Deshi t'i bënte varrin, po ra vetë brenda.

— S'kishte shpirt.

— Lëre, o Leze. — tha një plak dhe e hoqi thellë duhanin.

— Jo, or, jo, një çupë kam në shtëpi e asaj do t'i them: «E di ç'ke ti, moj bijë? Merr kë të ta dojë e bardha zemër. Po ama, hap sytë se ti do të kalosh jetën me të e jo unë.»

— S'e ke keq, o Laze.

— Të lumtë, xha Laze! — i tha Sadriti. —
Qenke burrë përparimtar.

— Më bëri koha, o bir! — u përgjegj xha
Lazja.

Kur dolën jashtë, zhurma e të thirrurat para
derës po rralloheshin. Njerëzit po largoheshin, duke
komentuar filmin drejt apartamenteve.

— Natën e mirë — tha Fatimja.

— Natën e mirë — u përgjegj Sadriti.

— Po ti, Sadrit, ku shkon? — pyeti Bukuria.

— Do përcjelli pak Zelian — u hodh Luljeta.

— Edhe ti, Luljetë?

— Po.

— Atëhere natën e mirë!

— Natën e mirë!

Të rinjtë u ndanë.

Ismaili, Sadriti, Luljeta dhe Zelia kaluan poshtë
repartit ushtarak, pastaj morën së bashku të për-
pjetën që të nxirrte te rezervuari. Nata që e butë,
e freskët e ledhatonjëse. Ata diskutonin mbi filmin
e ashtu pa e kuptuar u ndanë dy e dy. Sadriti dhe
Zelia ecën përpara, ndërsa Luljeta dhe Ismaili venin
pas. Dy të parët ecnin të ndrojtur, pa folur. Hëna,
e ngrënë dhe e zbetë, ndriçonte fare pak. Yje të
panumërt i vështronin nga lart. Ismaili dhe Luljeta
ecnin të zënë për dore kurse dy të tjerët që shko-
nin disa hapa para, ecnin të ndarë. Kur rruga ngu-
shtohet, kishte raste që takoheshin sup me sup.
Megjithatë s'flisnin. Ajo e ndjente veten shumë të
lumtur, ndërsa ai mendonte:

«Duhet t'i them që e dashuroj! Pse të mos ja
them? Është kaq e mirë.»

Të katër ecnin në heshtje. Degët e plepave, të

mbjellë pranë ujit, tundeshin nga era. Ai grumbull plepash dukej si një blok i zi. Të katër ata komu-
nikonin me njëri-tjetrin pa thënë asnjë fjalë.

Heshtjen e theu Luljeta.

— I shikon ata të dy si ecin?

— Po.

— Ata dashurohen.

— Vërtetë thua?

— Nuk e ke kuptuar këtë gjë?

— Jo. — tha ai. — Po s'është çudi. Ata duken sikur janë prerë për njëri-tjetrin.

— Do të dalë një çift i bukur.

— Një çift punëtor.

— Dhe janë shokët tanë— tha Luljeta.

Megjithëse flisnin ulët, zërat arritën deri te dy të rinjtë që ecnin përpara. Zelia tha:

— Ata po flasin.

— I dëgjoj.

— Po flasin për ne.

— Jam kureshtar të di se ç'thonë.

— I pyesim?

— Mirë.

— Luljetë, — u dëgjua zëri i Zelies. — për çfarë flisni?

Luljeta dhe Ismaili qeshën. Të qeshurat u shpërndanë deri larg mbi sipërfaqen e ujit. Pastaj ato pushuan e ra përsëri heshtja. Dëgjohej era që luante me degët e plepave, guakja e bretkosave dhe zhurma e ujit që derdhej diku.

— Hë, pra, për çfarë po flisnit?

— Doni ta dini? — tha Luljeta.

- Po — ja priti Sadriti.
- Për ju — u përgjegj Ismaili.
- Çfarë thoshit? — pyeti Sadriti.
- Luljeta ja ktheu menjëherë:
- Mos u bëj kureshtar se do të plakesh shpejt!
- dhe qeshi nën zë. Mbas asaj qeshje u vendos përsëri qetësia. Heshtje. Zhurma e ujit sa vente e shtohet.
- Për ujë nuk kemi keq — tha Luljeta sa për të thënë diçka.
- Rezervuari na ndihmon shumë.
- Por, ama, po të mos ishin krahët tona, as rezervuari s'do ishte bërë.
- Po ngjiteshin në të përpjetë.
- Ke lexuar gjë? — pyeti Sadriti Zelian.
- Po.
- Çfarë të pëlqen më shumë?
- Lexoj gjithshka — tha Zelia — Letërsi, libra politike...
- Hëna ecte e qetë mes yjeve të panumurt. Të rinjtë ecnin nëpër natë.
- Ti do largohesh, Ismail, do shkosh ushtar dhe...
- Të vjen keq?
- Jo s'di si të them, është një ndjenjë që s'e kupoj. Sikur më merr malli që tani.
- Në bregun e rezervuarit Sadriti dhe Zelia u ngjitën të parët. Dy të rinjtë u mbushën me frymë.
- Sa i bukur u dukërka natën! — tha vajza.
- A dëgjon si pëshpërit era me valët e vogla? Ecnin anës së ujit. Përsëri heshtën.
- Edhe dy të tjerët arritën në breg. Era ua rrë-

mbente flokët dhe luante me fustanet e vajzave.
Ata që ecnin përpara nuk flisnin.

— Të pëlqenka heshtja. — tha Zelia.

— Nuk e di. Por besoj se kur don të thuash diçka të sigurtë e të pastër, nuk ke pse të ngurrosh.

— Atëhere?

— Ti s'ke gjë për të thënë?

Ai qeshi dhe e kapi për dore, Zelia nuk e hoqi dorën.

Sadriti dhe Zelia ecnin të mbështetur te njëri tjetri.

— Sa e kam pritur këtë çast — tha ai.

— Edhe unë — u përgjegj ajo

— Sa mirë është kështu.

— Është e tmerrshme kur disa martohen pa u dashuruar.

Asaj i dukej se jetonte në një ëndërr, i dukej sikur e gjithë kjo nuk ishte e vërtetë. Ajo shquajti diçka aty përpara. U shtrëngua më fort mbas krahut të tij.

— Ç'pate? — e pyeti ai — është era që luan nga degët e pemëve.

— Jo, jo!

— Çfarë?

— Shiko përpara — tha ajo.

Ai hodhi sytë andej nga i tregoi vajza e pa një hije të zezë që lëvizte drejt tyre.

— Pse trembesh? — i tha — andej kalojnë shpesh njerëz.

— Jo, jo. Është Zyberi, e njoh. Më ka kërcënuar se, po të më shikojë me ty, do të...

— Mos u ndruaj. — tha ai. — Mos ki frikë.

Hija u afrua, u ndal para tyre.

— Ke shkrepse? — i tha Sadritit.

Ismaili dhe Lulieta qenë shumë mbrapa.

— Po, kam.

— Të ndez një cigare? Po peshkoja dhe imja u lag.

Sadriti po kërkonte shkrepset nëpër xhepe.

— Po ti?.. — i tha Zyberi Zelis. — Që kur ke filluar të bredhësh natën bregut të liqenit me dashnorë?

— Për këtë s'të jap llogari ty — u përgjegj vajza.

Sadriti gjeti shkrepset dhe ja zgjati.

— Na, ndize — i tha.

Zyberi shtrëngoi nofullat e shfryu me inat.

— Ti e di — i tha Sadritit — se kjo vajzë është e fejuara ime.

— Nuk e sheh që më ka futur krahun mua? Kush nga ne të pëlqen, moj Zelis?

— Ti — tha vajza me zë të fortë e të vendosur.

Me duar të dredhura, Zyberi shkrep shkrep sen e duke e mbrojtur nga era, ndezi cigaren. Flaka i ndriti fytyrën e egërsuar dhe u shua.

Luljeta, që e pa atë flakë, i tha Ismailit:

— Ata u takuan me dikë.

— Nuk besoj.

— Nuk e pe flakën?

— Sadriti duhet të ketë ndezur cigaren.

— Jo. Ata ishte tre.

— Eja të vemi shpejt.

Zyberi, kur pa se Sadriti që i vetëm, e mati me sy. Ai kish menduar shpesh ta rrihte, donte ta turpëronte në sy të vajzës.

— Na shkrepset — i tha.

Kur Sadriti zgjati dorën, ai ja futi me grusht hundëve. Sadriti u trondit pak, por nuk ra. Nuk priti më e iu hodh kundërshtarit. U kapën të dy për beli, u rrëzuan përtokë e përpiqeshin të godisnin njëri-tjetrin. Vendi ishte i tatëpjetë e ata u rrokullisën gjer në buzë të rezervuarit. Sadriti e ndieu se kundërshtari ishte i fortë. Duart e tij e shtrëngonin për beli dhe i merrnin frymën. E kish mbi trup dhe nuk qe aspak gjë e lehtë. Nga goja i dilte një erë e keqe, erë qepe e përzier me raki. Ai i bashkoi dy duart e ja vuri Zyberit nënë mjekër. Filloi ta shtynte me forcë. I dha trupit përpjetë, e ktheu në një anë, i vuri gjurin në gjoks e duart në fytyrë. Koka e Zyberit takonte në ujë e valët e vogla i lëpinin flokët. Mbi gjoks ndjente një peshë të rëndë, në grykë një palë darë e shtrëngonin. Lart në qiell, yjet vallëzonin, afroheshin, largoheshin, hapeshin, bashkoheshin, humbisnin përsëri e afroheshin.

Kështu i gjetën Luljeta dhe Ismaili. Mezi ja shqitën nga duart. Zyberi, kur u ngrit dhe pa se kishte ardhur Ismaili, iku pa folur. Humbi në errësirë si diçka e errët.

— I poshtri — tha Lulieta.

— Po të mos e shihja vetë, s'do ta besoja — tha Ismaili.

— Të thashë unë.

— U vrave gjë? — pyeti Zelia Sadritin.

— Jo, vetëm hunda m'u gërvisht pak.

Të katër u larguan nga rezervuari, ku lanë puthjet e erës me valët, hënën e yjet që laheshin dhe kujtimin e një grindje dashurie.

Erdhën ditë të bukura pranverore. Atë mëngjez Sadritit i doli gjumi më herët e po rrinte shtirë; dëgjoi zhurmë e cicërime nën dritare, zgjati kra-hun dhe e hapi. Një zog fluturoi tutje. Ishte një dallëndyshe. Pas tij fluturoi edhe një tjetër. Dy zogjtë u endën për pak çaste në qiellin e kulluar e u ndalën pak më tej, te vija e përroit.

Sadriti i pa përsëri kur erdhën te dritarja. Në sqepe mbanin baltë të cilën e ngjitnin me shkath-tësi e mjeshtëri të çuditshme pas murit. Sadriti u ngrit e qëndroi në dritare. Zogjtë punonin dhe çuçu-risnin. Ata fluturonin nga dritarja në përrua, nga përroi në dritare e Sadriti i vështronte me sy të qeshur. Dallëndyshet nuk trembeshin prej tij. Flutu-ronin fare pranë djaloshit, punonin e cicëronin të gëzuara. «Dallëndyshet po ngrënë çerdhen» mendoi Sadriti, «Sa mirë që erdhën te dritarja ime!»

Nga këto mendime e nxori Agimi, që u zgjua atë çast.

— E, ç'po vështron ashtu?

— E gjen dot?

— Mos shikon ndonjë vajzë që po shkon në punë? —

Sadriti qeshi me gjithë shpirt.

— Kurrë s'ke për ta gjetur — tha ai — vësh-troj dallëndyshet.

— Dallëndyshet?

— Po. Ato kanë ardhur në dritaren tonë.

Agimi, që po paloste jorganin, vrapoi pranë të vëllait.

Edhe ai i pa dallëndyshet që po fluturonin në

ajrin e mëngjezit. Ato dredhonin, merrnin baltë dhe punonin për çerdhen e re.

— Sa të bukura janë! — tha Agimi.

Dy vëllezërit, pranë e pranë, të mbështetur në dritare, ndiheshin të gëzuar.

— Tani eja të rregullojmë shtëpinë. Na përgatit diçka të ngrohtë për babanë — tha Agimi që ish më pak romantik.

— Si urdhëron, shoku «komandant» — tha Sadriti me të qeshur. — Unë mendoj se në përgatitjen që bëjmë «gjenerali» ynë do kënaqet.

— Ndoshta me mëngjezin po, por në drejtimet e tjera ti s'po tregohesh strateg i fortë.

— Në ç'drejtim?

— E di ti ku i rreh plakut. Ai e ka mendjertë martesa.

Dy vëllezërit qeshën dhe iu përveshën punëve të shtëpisë.

Pastaj Sadriti u nis për në sektor. Jashtë ndjeu flladin e freskët, që i lëmoi fytyrën e i përkëdheli flokët.

Në brigadë kishin ardhur të gjithë e po hanin mëngjezin. Kur dolën jashtë, Luljeta u tha shoqeve:

— Na ka ardhur një letër nga Ismaili, a e lexojmë së bashku?

— Mirë — thanë të gjithë.

— Mos ka ndonjë gjë që s'duhet ta dëgjojmë ne të tjerët? — bëri shaka Fatimja.

— Jo — u përgjegj Luljeta me buzë në gaz. —

Ato të tjerat m'i ka shkruar veç.

Të gjithë, ashtu në këmbë, dëgjonin zërin tingëllonjës të Luljetës, e cila lexonte letrën e shokut të tyre ushtar.

«Të dashur shokë e shoqe,

U bënë kohë që s'jemi parë e, t'ju them të drejtën, më ka marrë malli. Shpesh, kur jam postëkapanoni, dëgjoj erën se si grindet nëpër strehën e bujtinës, dëgjoj frymëmarrjet e shokëve të rinj, që flenë të qetë. I ndej të afërt se këta kudo janë me mua, janë si unë, ushtarë.

Po, në të njëjtën kohë, më shtohet edhe dashuria për ju. Më besoni. Më shkruani dhe mirupafshim. Gjithnjë juaji, Ismaili».

Të gjithë dëgjonin me vëmendje e secili mendonte shokun që ishte larg.

— Kur do t'i përgjigjemi?

— Fjalë është ajo? — tha Zelia. — Që sot!

Sadriti e shikoi me miratim.

— Unë mendoj — tha Bukuria — që me këtë punë të merresh ti shoqja brigadiere.

— Po — thanë të gjithë.

Luljeta qeshi me kënaqësi.

— Tani të nisemi në punë — tha ajo.

Të gjithë u nisën në frontin e punës. Ecnin drejt kodrës gurpe - grupe e bisedonin.

— Shkoni përpara — u tha Luljeta Sadritit e Zelis — shkoni se kam punë. Do t'ju arrij.

Ata të dy ecnin në fund të atij vargu punëtorësh që po ngjitej kodrës. Tani të gjithë e dinin se ata do fejojeshin. Të gjithë u gëzuan kur mësuan këtë gjë. Rremë Qylafi kish varur turinjtë e zvarri-sej mbas qerres. Dhe Dulla kishte filluar të zbutej.

— Ç'thotë yt atë? — pyeti Sadriti, kur pa se Dulla i vështronte nga larg.

— Ç'të thotë?

Ndërkaq arritën te tenda majë kodrës. Vreshti kishte marrë një ngjyrë të gjelbër dhe një cipë e përhime, e hollë shtrihej mbi gjethet e porsaçelura të hardhive, në vreshtën tarraca-tarraca. Ata u panë në sy dhe qeshën të lumtur.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Babai	3
Lumtëria	8
Në katin e pestë	15
Filli u lidh përsëri	20
Dallandyshtet e para	25